Kumbona e së Diellës

Ylli i Betlehemit (c.1885–1890) - Sir Edward Burne-Jones

Urime Krishtlindjen dhe Vitin e Ri 2016

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.11/12, Nëntor - Dhjetor 2015

ME LINDJEN E KRISHTIT, HYJI NA KA KTHYER DINJITETIN TONË

Mesazhi i urimeve për Krishtlindjen 2015

Për Krishtlindje, çdo vit, ne të krishterët e kemi zakon të shkëmbejmë urimet sepse ngjarja të cilën e kremtojmë ka për ne një rëndësi shumë të madhe: Biri i Hyjit dëftohet në formë njerëzore (krh. Fil 2,7), merr natyrën tonë të pa mbrujtur nga mëkati për ta hyjnizuar dhe për të na dhënë pushtetin të bëhemi edhe ne bij të Hyjit (krh. Gjn 1,12).

Dhe ndërsa jemi të ftuar të shikojmë përvujtërinë e Mesisë, nuk mund të mos marrim parasysh se, falë tij, njerëzimi ynë, qenia jonë burra e gra, merr një dinjitet të mrekullueshëm.

Mëkati ynë, papërsosuritë që na përkasin pikërisht sepse jemi qenie njerëzore dhe prandaj të papërsosur, në vend që të na largojnë prej Hyjit, e afrojnë atë më shumë me ne: Hyji zgjedh të bëhet njëri prej nesh. Sot do ta përdorim fjalën "integrim" për të përshkruar ngjarjen e Mishërimit të Birit të Hyjit.

Shtegtar dhe i huaj (krh. Heb 11,13) – "mbretëria ime nuk është e kësaj bote", do të thotë para Pilatit (Gjn 18,36) – ka kaluar mes nesh duke shëruar e duke u bërë mirë të gjithëve (krh. Vap 10, 38); në mënyrë koherente me zgjedhjen kaq të përvuajtur për t'u zhveshur nga hyjnia e vet (krh. Fil 2,7), i nënshtrohet të njëjtit fat vdekatar të njerëzve për ta mposhtur vdekjen dhe për t'u lejuar të gjithëve të hyjnë në jetën hyjnore. Kështu, dinjiteti i krijesave të bëra në shëmbëlltyrë e përngjasim të Hyjit, i përçudnuar prej mëkatit të rrjedhshëm, na kthehet në mënyrë të begatshme: "kur u shumëzua mëkati, shumë më i begatshëm u bë hiri" (Rom 5,20), sepse në Jezusin "u duk hiri i Hyjit" (Tit 2,11).

Nëse kjo është festa e Krishtlindjes, atëherë duhet të lirohemi prej konsumizmit që e kthen atë vetëm në tregti, por edhe prej të gjitha atyre formave që e përçudnojnë dhe e bëjnë ta humbë shijen e vet origjinale, sidomos lëshimet që gjatë kësaj periudhe mund të bëhen. Në të vërtetë, kjo është koha që duhet t'i kushtohet sa më shumë fesë së jetuar: ta shikojmë Hyjin për të mësuar, prej veprimit të tij ndaj njerëzve, si të veprojmë ne vetë.

Pastaj është koha e volitshme për t'i kushtuar më shumë vëmendje dinjitetit njerëzor: sepse nëse Hyji na ka kthyer dinjitetin tonë, edhe ne duhet ta vlerësojmë dinjitetin e të afërmit tonë. Kjo do të thotë: të punojmë për të zhdukur padrejtësitë e çfarëdo lloji; të bëjmë çdo përpjekje për ta pakësuar varfërinë, sidomos atë kulturore; të dimë të kërkojmë falje dhe të falim fyerjet e pësuara. Vetëm kështu do ta vlerësojmë dinjitetin tonë dhe atë të të tjerëve.

Së fundi, Krishtlindja e këtij viti gjendet brenda festimeve për 25-vjetorin e fesë së rilindur në Vendin tonë: le të bëjmë që të mos ndodhë ta humbasim përsëri atë për fajin apo dembelinë tonë. Por Krishtlindja bie edhe në Vitin e Shenjtë të Mëshirës, të dëshiruar shumë prej Papa Françeskut, të cilit i jemi mirënjohës sepse, nëpërmjet këtij Jubileu, jo vetëm na lejon të përdorim në mënyrë të begatshme hirin e faljes së Hyjit, por edhe na lejon të mësojmë që të jemi "të mëshirshëm sikurse Ati".

Kështu, urimi që ju drejtoj të gjithëve është që ta jetojmë këtë festë të Lindjes së Zotit Jezus si rast të volitshëm për të rizbuluar dinjitetin tonë si krijesa të dashura prej Krijuesit dhe për t'i kthyer të njëjtin dinjitet të afërmit tonë në çfarëdo niveli: personal, familjar, shoqëror, formues, punëtor e institucional.

Po përfundoj me fjalët e Sh. Leonit të Madh, që do t'i dëgjojmë në Vigjiljen e Natës së Shenjtë: "Njihe dinjitetin tënd!".

Urime të gjithëve ju, jo vetëm besimtarëve në Krishtin por, siç thanë engjëjt që u dëftuan në Betlehem natën e Krishtlindjes, edhe të gjithë "njerëzve që Hyji i ka për zemër" (Lk 2,14), qofshin besimtarë të çdo feje qofshin jo besimtarë, sepse Krishtlindja është festa e Hyjit, por është edhe festa e dinjitetit të rigjetur të njeriut. Urime!

Për shumë vjet!

Arqipeshkvi Juaj

Imzot Angelo Massafra

Papa Françesku
DITA E RINISË 4

Don Anton Ukaj
KRISHTLINDJA 7

Don Nosh Gjolaj
LUFTA PËR TË MPOSHTUR PUSHTETIN 10

Dom Nikë Ukgjini
IMZOT RROK MIRDITA 15

Don Lush Gjergji
CHARLES DE FOUCAULD 16

Lukë Shestani
RADIO VATIKANI 19

Dom Nikë Ukgjini
KISHA HOTIT 20

Ndue Dedaj
MESHA E PARË E ERËS SË RE 24

Violeta Murati
NË KISHËN E MJEDËS 26

Nikollë Kerhana
OFSHAMA E ANTON PASHKUT 28

Redaksia
INJAC ZAMPUTI 30

Redaksia
PROMOVIM LIBRI DOM NDOC NIKAJ 31

VITRINA E LIBRIT 32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXIX, nr. 11/12 (481-482) Nëntor - Dhjetor 2015

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
***Imzot* Angelo MASSAFRA**

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Loreta Tomaj

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
nike.ukgjini@gmail.com
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

MESAZHI E ATIT TË SHENJTË, FRANÇESKUT, ME RASTIN E DITËS XXXI BOTËRORE TË RINISË 2016

«Lum të mëshirshmit, sepse do të gjejnë mëshirë.» (Mt5,7)

Të dashur të rinj e të reja,
kemi mbërritur në fazën e fundit të shtegtimit tonë drejt Krakovit, ku vitin e ardhshëm, në muajin korrik, do të festojmë së bashku Ditën XXXI Botërore të Rinisë. Në ecjen tonë të gjatë dhe angazhuese jemi udhëhequr nga fjalët e Jezusit të marra nga "predikimi në mal". E kemi nisur këtë rrugëtim në vitin 2014, duke medituar së bashku mbi Lumturinë e parë: «Lum skamnorët në shpirt, sepse e tyre është Mbretëria e Qiejve» (Mt5,3). Tema e vitit 2015 ishte: «Lum të pastrit në zemër, sepse do ta shohin Hyjin» (Mt5,8). Në vitin që po na pret duam të lejojmë të frymëzohemi nga fjalët: «Lum të mëshirshmit, sepse do të gjejnë mëshirë» (Mt5,7).

Jubileu i Mëshirës

Me këtë temë të DBR-së së Krakovit 2016, futemi në Vitin e Shenjtë të Mëshirës, duke u bërë një Jubile i mirëfilltë Rinor në nivel botëror. Nuk është hera e parë që një bashkim ndërkombëtar i të rinjve përkon me një Vit jubilar. Në fakt, ishte Viti i Shenjtë i Shëlbimit (1983-1984) kur Shën Gjon Pali II thirri për herë të parë të rinjtë nga e gjithë bota për të Dielën e Larit. Pastaj, ndodhi që, në Jubileun e Madh të vitit 2000, më shumë se dy milionë të rinj nga rreth 165 vende u mblodhën në Romë për Ditën XV Botërore të Rinisë. Siç ndodhi në këto dy raste të mëparshme, jam i sigurt se Jubileu i Rinisë në Krakov do të jetë një prej momenteve të forta të këtij Viti të Shenjtë!

Ndoshta disa prej jush do të pyesin: çfarë është ky Vit jubilar që po kremtohet në Kishë? Teksti biblik i Librit të Levitikut 25 na ndihmon të kuptojmë se çfarë nënkupton një "jubile" për popullin e Izraelit: çdo pesëdhjetë vjet, hebrenjtë dëgjonin zërin e trombës (jobel) që i thërriste (jobil) për kremtimin e një viti të shenjtë, si një kohë pajtimi (jobal) për të gjithë. Në këtë periudhë, duhej rivendosur një marrëdhënie e mirë me Hyjin, me të afërmin dhe me krijimin, bazuar në dhurimin falas. Prandaj, ndër të tjera, përnxitej falja e borxheve, një ndihmë e veçantë për këdo që kishte rënë në mjerim, përmirësimi i marrëdhënieve mes njerëzve dhe lirimi I skllevërve.

Jezu Krishti erdhi që ta shpallte dhe ta kryente kohën e vazhdueshmetë hirit të Zotit, duke u sjellë të varfërve lajmin e gëzuar, lirinë të burgosurve, shikimin të verbërve dhe çlirimin të shtypurve (Krh. Lk 4,18-19). Në Të, sidomos në Misterin e tij Pashkvor, kuptimi më i thellë i jubileut gjente përmbushje të plotë. Kur Kisha bën thirrje për një jubile në emër të Krishtit, të gjithë jemi të ftuar që të jetojmë një kohë të jashtëzakonshme hiri. Vetë Kisha është e thirrur që t'i ofrojë me bollëk shenjat e pranisë dhe afërsisë së Hyjit, që të zgjojë në zemrat e njerëzve aftësinë për të parë atë çfarë është thelbësore. Në mënyrë të veçantë, ky Vit i Shenjtë i Mëshirës «është koha që Kisha ta gjejë kuptimin e misionit që ia ka besuar Zotëria në ditën e Pashkës: të jetë vegël e mëshirës së Atit» (Homelia në Mbrëmësoren e parë të së Dielës së Mëshirës Hyjnore, 11 prill 2015).

Të mëshirshëm si Ati

Motoja e këtij Jubileu të jashtëzakonshëm është: «Të mëshirshëm si Ati» (Krh. Misericordiae Vultus, 13), dhe me këtë intonohet dhe tema e DBR-së së ardhshme. Prandaj, të përpiqemi ta kuptojmë më mirë se çfarë nënkupton mëshira hyjnore.

Besëlidhja e Vjetër kur flet për mëshirën përdor terma të ndryshëm, ku ndër më domethënësit janë heseddherahamim. I pari, që i vishet Hyjit, shpreh besnikërinë e tij të palodhshme ndaj Besëlidhjes me popullin e vet, që Ai e do dhe e fal në

përjetësi. I dyti, rahamim, mund të përkthehet si "të brendshme", duke iu referuar në veçanti barkut amnor dhe duke na bërë ta kuptojmë dashurinë e Hyjit për popullin e vet si atë të një nëne për fëmijën e saj. Kështu na e paraqet Isaia profet: «E harron - thua - gruaja foshnjën e vet,që të mos ketë dhimbje për bamin e barkut të vet?Po edhe nëse ndonjëra do të harronte,unë ty kurrë nuk të harroj!» (Is49,15). Një dashuri e këtij lloji nënkupton që t'i bësh vend tjetrit brenda vetes, të ndjesh, të vuash e të gëzosh me tjetrin.

Në konceptin biblik të mëshirës përfshihet edhe konkretësia e një dashurie që është besnike, falas dhe që di të falë. Në këtë pjesë të Ozeas profet kemi një shembull të bukur të dashurisë së Hyjit, që krahasohet me atë të një ati përballë birit të vet: «Kur Izraeli ende ishte djalëunë e dojae prej Egjiptit e thirra birin tim.Por, sa më shumë i thirrja,aq më tepër largoheshin prej meje;[…] E unë e mësoja Efraimin të ectevetë i mbartja para duarsh,s'e kuptonin se për ta kujdesesha.I tërhiqja me litarë për njerëz,me zinxhirë të dashurisë;isha për ta,porsi ai që fëmijën e ngrederi në mollëzat e veta,përkulesha mbi të t'i jap të hajë» (Os11,1-4). Pavarësisht sjelljes së gabuar të birit, që e meritonte ndëshkimin, dashuria e atit është besnike dhe e fal gjithmonë birin e penduar. Siç e shohim, në mëshirë përfshihet gjithmonë falja; ajo «nuk është një ide abstrakte, por një realitet konkret me të cilin Ai e zbulon dashurinë e vet si atë të një ati dhe të një nëne që prekenderi në thellësinë e kraharoritpër birin e vet. […] Del nga thellësia si një ndjenjë e thellë, e natyrshme, plot butësi dhe dhembshuri, ndjesë dhe falje» (Misericordiae Vultus, 6).

Besëlidhja e Re na flet për mëshirën hyjnore (eleos) si përmbledhja e veprës që Jezusi erdhi ta kryente në botë në emrin e Atit (Krh. Mt9,13). Mëshira e Zotërisë sonë dëftohet sidomos kur Ai përkulet mbi mjerimin njerëzor dhe e tregon dhembshurinë e tij ndaj atyre që kanë nevojë për kuptim, shërim dhe falje. Gjithçka në Jezusin flet për mëshirë. Madje, Ai vetë është mëshira.

Në kapitullin 15 të Ungjillit sipas Lukës, mund të gjejmë tre shëmbëlltyrat e mëshirës: atë të deles së humbur, atë të monedhës së humbur dhe atë që njihet si shëmbëlltyra e "djalit të humbur". Në këto tre shëmbëlltyra na godet gëzimi i Hyjit, gëzimi që Ai e ndjen kur e gjen një mëkatar dhe e fal. Po, gëzimi i Hyjit është falja! Këtu përmblidhet i gjithë Ungjilli. «Secili prej nesh është delja e humbur, ajo monedha e humbur; secili prej nesh është ai biri që e ka shkapërderdhur lirinë e vet duke ndjekur idhujt e rrejshëm, mirazhet e lumturisë, dhe humbi gjithçka. Por Hyji nuk na harron, Ati nuk na braktis kurrë. Është një atë i durueshëm, na pret gjithmonë! E respekton lirinë tonë, por mbetet gjithmonë besnik. Dhe kur kthehemi tek Ai, na pret si bij, në shtëpinë e tij, sepse nuk pushon kurrë, as edhe për një çast, duke na pritur me dashuri. Dhe zemra e tij feston për çdo bir që kthehet. Feston sepse është gëzim. Hyji e ka këtë gëzim kur një mëkatar prej nesh shkon tek Ai dhe e kërkon faljen e tij» (Angelus, 15 shtator 2013).

Mëshira e Hyjit është shumë konkrete dhe të gjithë jemi të thirrur që ta përjetojmë vetë atë. Kur isha 17 vjeç, një ditë kur duhet të dilja me miqtë e mi, vendosa të kaloja më parë nga kisha. Aty gjeta një meshtar që më frymëzoi një besim të veçantë dhe ndjeva dëshirën që ta hapja zemrën time në Rrëfim. Ai takim ma ndryshoi jetën! Zbulova se kur e hapim zemrën me përvujtëri dhe transparencë, mund ta kundrojmë në mënyrë shumë konkrete mëshirën e Hyjit. Pata sigurinë se, në personin e atij meshtari, ishte Hyji që po më priste tashmë, përpara se unë ta bëja hapin e parë për të shkuar në kishë. Ne e kërkojmë, por Ai na paraprin gjithmonë, na kërkon që gjithmonë, dhe na gjen i pari. Ndoshta dikush prej jush e mban një peshë në zemrën e vet dhe mendon: kam bërë këtë e kam bërë atë… Mos kini frikë! Ai ju pret! Ai është atë: na pret gjithmonë! Sa bukur është të takojmë në Sakramentin e Pajtimit përqafimin e Atit, ta zbulojmë rrëfyestoren si vendin e Mëshirës, të lejojmë të prekemi nga kjo dashuri e mëshirshme e Zotit që na fal gjithmonë. Dhe ti, i dashur i ri, e dashur e re, a ke ndjerë të shtrihet mbi ty ky shikim dashurie të pafund, që përtej krejt mëkateve, kufizimeve, dështimeve të tua vazhdon të ketë besim te ti dhe ta shohë me shpresë ekzistencën tënde? A je i vetëdijshëm për vlerën që e ke para Hyjit, i cili për dashuri të ka dhënë gjithçka? Siç na mëson Shën Pali, «Hyji e dëftoi dashurinë e vet kundrejt nesh kështu: ndërsa ne ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne» (Rom5,8). Por, a e kuptojmë vërtet fuqinë e këtyre fjalëve?

E di se sa i dashur është për ju kryqi i DBR-së – dhuratë e Shën Gjon Palit II – që i shoqëron të gjitha takimet tuaja botërore që nga viti 1984. Sa ndryshime, sa kthime të mirëfillta kanë buruar në jetën e shumë të rinjve që nga takimi me këtë kryq të zhveshur! Ndoshta ia keni bërë vetes pyetjen: nga vjen kjo fuqi e jashtëzakonshme e kryqit? Ja, pra, përgjigjja: kryqi është shenja më elokuente e mëshirës së Hyjit! Ajo na vërteton se masa e dashurisë së Hyjit përballë njerëzimit është të duash pa masë! Në kryq mund ta prekim mëshirën e Hyjit dhe të lejojmë të prekemi nga vetë mëshira e tij! Këtu do të dëshiroja të kujtoja episodin e dy cubave

të kryqëzuar përkrah Jezusit: njëri prej tyre është mendjemadh, nuk e njeh veten mëkatar, e tall Zotërinë. Tjetri, përkundrazi, e pranon se ka gabuar, i drejtohet Zotërisë dhe i thotë: «Jezus, kujtohu për mua kur të hysh në mbretërinë tënde». Jezusi e shikon me mëshirë të pafundme dhe i përgjigjet: «Sot do të jesh me mua në Parajsë» (Krh. Lk 23,32.39-43). Me cilin prej të dyve identifikohemi? Me atë që është mendjemadh dhe nuk i pranon gabimet e veta? Apo me tjetrin, që e pranon veten si nevojtar për mëshirën hyjnore dhe e kërkon me gjithë zemër? Në Zotërinë, që e ka dhënë jetën e tij për ne në kryq, do ta gjejmë gjithmonë dashurinë e pakushtëzuar që e njeh jetën tonë si një të mirë dhe na e jep gjithmonë mundësinë për të rifilluar.

Gëzimi i jashtëzakonshëm i të qenurit mjete të mëshirës së Hyjit

Fjala e Hyjit na mëson se «është më i lumtur ai që jep se ai që merr» (Vap 20,35). Pikërisht për këtë arsye, Lumturia e pestë i shpall të lumtur të mëshirshmit. E dimë se Zoti na ka dashur i pari. Por, do të jemi vërtet të lumë, të lumtur, vetëm nëse do të hyjmë në logjikën hyjnore të dhurimit, të dashurisë falas, nëse do ta zbulojmë se Hyji na ka dashur pafundësisht për të na bërë të aftë të duam si Ai, pa masë. Siç thotë Shën Gjoni: «

Të dashur, ta duam njëri-tjetrin, sepse dashuria vjen nga Hyji, dhe, secili që ka dashuri, ka lindur prej Hyjit dhe Hyjin e njeh.Kush nuk ka dashuri, nuk e ka njohur Hyjin, sepse Hyji është dashuri.[…] Dashuria përmbahet në këtë: Jo se ne e kemi dashur Hyjin, por – Ai na ka dashur ne dhe e ka dërguar Birin e vet si fli pajtuese për mëkatet tona.Të dashur, në qoftë se Hyji na ka dashur ashtu, edhe neve na duhet ta duam njëri-tjetrin» (1 Gjn 4,7-11).Pasi jua kam shpjeguar në mënyrë shumë përmbledhëse se si e ushtron Zoti mëshirën e tij me ne, do të dëshiroja t'ju sugjeroj se si mund të jemi konkretisht mjete të kësaj mëshirë ndaj të afërmit tonë.

Më vjen në mend shembulli i të Lumit Pierxhorxho Frasati. Ai thoshte: «Jezusi më viziton çdo mëngjes në Kungim, kurse unë ia kthej në mënyrën më të mjerë që mundem, duke i vizituar të varfrit». Pierxhorxho ishte një i ri që e kishte kuptuar se çfarë do të thotë të kesh një zemër të mëshirshme, të ndjeshme ndaj më nevojtarëve. Atyre u jepte më shumë se vetëm gjëra materiale; u jepte vetveten, harxhonte kohë, fjalë, aftësi dëgjimi. U shërbente të varfërve me fshehtësi të madhe, duke mos e treguar asnjëherë veten. E jetonte me të vërtetë Ungjillin që thotë: «Ndërsa ti, kur të bësh lëmoshë, të mos dijë e majta çfarë bën e djathta, që lëmosha jote të jetë e fshehtë» (Mt6,3-4). Mendoni se një ditë para vdekjes së tij, për së tepërmi i sëmurë, jepte urdhra se si t'i ndihmonte miqtë e tij në vështirësi. Në funeralin e tij, familjarët dhe miqtë mbetën të shtangur nga prania e shumë të varfërve që ata nuk i njihnin, të cilit i riu Pierxhorxho i kishte ndjekur dhe ndihmuar.

Më pëlqen gjithmonë që t'i bëj bashkë Lumturitë ungjillore me kapitullin 25 të Mateut, kur Jezusi na i paraqet veprat e mëshirës dhe thotë se ne do të gjykohemi në bazë të tyre. Prandaj, ju ftoj që t'i zbuloni veprat e mëshirës trupore: t'u jepni të hanë të uriturve, të pinë të eturit, t'i vishni të zhveshurit, t'i pranoni të huajt, t'i ndihmoni të sëmurët, t'i vizitoni të burgosurit, t'i varrosni të vdekurit. Dhe të mos harrojmë edhe veprat e mëshirës shpirtërore: t'i këshillojmë ata që dyshojnë, t'i mësojmë të paditurit, t'i qortojmë mëkatarët, t'i ngushëllojmë të lënduarit, t'i falim fyerjet, t'i durojmë me durim personat bezdisës, ta lusim Hyjin për të gjallët e për të vdekurit. Siç e shihni mëshira nuk është "të jesh i mirë", as thjesht sentimentalizëm. Këtu vërtetohet vërtetësia e të qenurit tonë nxënës të Jezusit, të besueshmërisë tonë si të krishterë në botën e sotme.

Ju të rinjve, që jeni shumë konkret, do të dëshiroja t'ju propozoja, për shtatë muajt e parë të vitit 2016, që në secilin muaj të zgjidhni e të zbatoni një vepër të mëshirës trupore dhe një të mëshirës

shpirtërore. Frymëzohuni nga lutja e Shën Faustinës, apostulle e përvuajtur e Mëshirës Hyjnore në kohët tona:

«Më ndihmo, o Zot, që të bëj që […]

sytë e mi të jenë të mëshirshëm, në mënyrë që unë të mos ushqej kurrë dyshime dhe të mos gjykoj bazuar në dukjet e jashtme, por që të di ta dalloj atë çka është e bukur në shpirtin e të afërmit tim dhe t'i bëhem ndihmë […]

dëgjimi im të jetë i mëshirshëm, që të përkulem para nevojave të të afërmit tim, që veshët e mi të mos jenë shpërfillës ndaj dhimbjeve dhe ofshamave të të afërmit tim […]

gjuha ime të jetë e mëshirshme dhe të mos flas kurrë keq për të afërmin, por ta kem për secilin një fjalë ngushëllimi dhe faljeje […]

duart e mia të jenë të mëshirshme dhe plot me vepra të mira […]

këmbët e mia të jenë të mëshirshme, në mënyrë që unë t'i shkoj gjithmonë në ndihmë të afërmit, duke fituar mbi plogështinë dhe lodhjen time […]

zemra ime të jetë e mëshirshme, në mënyrë që të marr pjesë në të gjitha vuajtjet e të afërmit»(Ditari, 163).

Mesazhi i Mëshirës Hyjnore përbën kështu një program jete shumë konkret dhe kërkues që kërkon vepra. Dhe një prej veprave të mëshirës më të dukshme, por ndoshta ndër më të vështirat për t'u zbatuar, është ajo e faljes së atyre që na kanë fyer, që na kanë bërë keq, që ne i konsiderojmë si armiq. «Sa e vështirë duket shumë herë të falësh! E megjithatë, falja është mjeti i vendosur në duart tona të brishta për ta arritur qetësinë e zemrës. Të lejojmë të bjerë mllefi, zemërimi, dhuna dhe hakmarrja, është kusht i domosdoshëm për të jetuar të lumtur» (Misericordiae Vultus, 9).

Takoj shumë të rinj që thonë se janë të lodhur nga kjo botë kaq e ndarë, në të cilën hasen me mbështetës të fraksioneve të ndryshme, ku ka shumë luftëra dhe madje ka njerëz që e përdorin edhe fenë e vet si arsyetim për dhunën e tyre. Duhet t'i përgjërohemi Zotit që të na e dhurojë hirin të jemi të mëshirshëm me ata që na bëjnë keq. Si Jezusi që mbi kryq lutej për ata që e kishin kryqëzuar: «Fali, o Atë, se nuk dinë çfarë bëjnë» (Lk23,34). Rruga e vetme për të fituar mbi të keqen është mëshira. Drejtësia është e nevojshme, patjetër, por e vetme nuk mjafton. Drejtësia dhe mëshira duhet të ecin së bashku. Sa do të doja që të bashkoheshim të gjithë në një lutje të zëshme, nga thellësia e zemrave tona, duke u lutur që Zoti të ketë mëshirë për ne dhe për botën mbarë!

Krakovi na pret!

Ngelin edhe pak muaj deri në takimin tonë në Poloni. Krakovi, qyteti i Shën Gjon Palit II dhe Shën Faustina Kovalskës, na pret me krahët dhe zemrën hapur. Besoj se Provania Hyjnore na ka udhëhequr që ta kremtojmë Jubileun e të Rinjve pikërisht atje, ku kanë jetuar këto dy apostuj të mëdhenj të mëshirës së kohëve tona. Gjon Pali II e ka perceptuar se kjo ishte koha e mëshirës. Në fillimin e papnisë së tij, ai shkroi Enciklikën Dives in misericordia. Në Vitin e Shenjtë 2000, ai kanonizoi Motër Faustinën, duke themeluar edhe Festën e Mëshirës Hyjnore, në të dielën e dytë të Pashkës. Dhe në vitin 2002, e përuroi vetë personalisht, në Krakov, Shenjtëroren e Jezusit të Mëshirshëm, duke ia besuar botën Mëshirës Hyjnore dhe duke shpresuar që ky mesazh t'iu mbërrijë të gjithë banorëve të tokës dhe t'i mbushë zemrat me shpresë: «Duhet ta ndezim këtë shkëndijë të hirit të Hyjit. Duhet t'ia transmetojmë botës këtë zjarr mëshire. Në mëshirën e Hyjit, bota do ta gjejë paqen, dhe njeriu lumturinë!» (Homelia për Kushtimin e Shenjtërores së Mëshirës Hyjnore në Krakov, 17 gusht 2002).

Fort të dashur të rinj e të reja, Jezusi i mëshirshëm, piktura që nderohet nga populli i Hyjit në Shenjtëroren e Krakovit kushtuar Atij, ju pret. Ai ka besim te ju dhe llogarit në ju!Ka shumë gjëra të rëndësishme për t'ia thënë secilit dhe secilës prej jush… Mos kini frikë t'i ngulitni sytë e tij të mbushur me dashuri të pafundme përballë jush dhe lejoni që t'ju mbërrijë shikimi i tij i mëshirshëm, i gatshëm që ta falë çdo mëkat tuajin, një shikim që është në gjendje ta ndryshojë jetën tuaj dhe t'i shërojë plagët e shpirtrave tuaj, një shikim që e shuan etjen e thellë që banon në zemrat tuaja të reja: etje për dashuri, paqe, gëzim, dhe lumturi të vërtetë. Ejani tek Ai dhe mos kini frikë! Ejani që t'i thoni nga thellësia e zemrave tuaja: "Jezus, unë besoj në Ty!" Lejoni që të prekeni nga mëshira e tij pa kufij për t'u bërë edhe ju apostuj të mëshirës përmes veprave, fjalëve dhe lutjeve, në botën tonë të plagosur nga egoizmi, urrejtja dhe dëshpërimi i madh.

Çojeni flakën e dashurisë së mëshirshme të Krishtit – për të cilën ju ka folur Shën Gjon Pali II – në mjediset e jetës sonë të përditshme e deri në skajet e botës. Në këtë mision, unë ju shoqëroj me urimet dhe lutjet e mia, ju besoj të gjithëve në duart e Marisë Virgjër, Nënës së Mëshirës, në këtë pikë të fundit të ecjes së përgatitjes shpirtërore në DBR-në e ardhshme të Krakovit, dhe ju bekoj të gjithëve nga zemra.

Don Anton UKAJ
Shkodër

KRISHTLINDJA: VEPËR E MËSHIRËS HYJNORE

Shumë herë kemi dëgjuar: në familje, në katekizëm, në predikime të meshtarëve e ndoshta edhe kemi lexuar në revista apo libra të ndryshëm se me lindjen e Krishtit botës ju është kthyer harmonia, gëzimi, paqja, dashuria, shpresa dhe jeta. Por, nëse ndalemi dhe e shqyrtojmë zemrën tonë, do të zbulojmë se brenda saj ka shumë inat, xhelozi, mllef, pakënaqësi, ndarje, përçarje... e sigurisht do të bënim pyetje: ku është gëzimi i Krishtlindjes? Po të kalonim nga shqyrtimi i zemrës te vlerësimi i familjes gjithashtu do të takonim mërzi, monotoni, egoizëm, indiferentizëm, hakmarrje, interes, vetmi... po ashtu do të pyetnim: ku është harmonia që solli Foshnja hyjnore? Kalimi nga familja dhe ballafaqimi me shoqërinë dhe realitetin e botës që na rrethon do të shndërrohej në një vlerësim gjithnjë e më të hidhur e pesimist, sepse nuk e kemi të vështirë të individualizojmë materializmin, relativizmin, hedonizmin, korrupsionin, padrejtësinë, varfërinë, krimin, luftën... e gjithashtu do t'i shtronim vetës pyetje: ku është paqja e Krishtit të mishëruar? Ku është?

Kësaj pyetje e cila mund të burojë, jo vetëm nga zemra e një jo besimtari, mund t'i japim përgjigje të saktë dhe të kënaqshme vetëm nëse mbështetemi në Fjalën e Hyjit dhe nga aty nxjerrim përgjigjen. Shën Gjoni ungjilltar që në rreshtat e parë të Ungjillit i jep përgjigje përfundimtare kësaj pyetje: "Drita e vërtetë që shndrit çdo njeri, erdhi në botë. Ishte në botë e bota u krijua prej Saj, e bota nuk e njohi. Erdhi ndër të vetët, e të tijtë nuk e pranuan. Atyre që e pranuan dha zotësinë të bëhen bijtë e Hyjit: atyre që besojnë në Emrin e tij. Këta s'i bëri bij të Hyjit as gjaku as prirja e mishit as prirja e njeriut por – Hyji" (Gjn 1, 9-13).

"Erdhi ndër të vetët, e të tijtë nuk e pranuan". Këtu gjendet përgjigja, këtu qëndron problemi: mospranimi i Jezusit ndërlidhet ngushtë me refuzimin e të gjitha vlerave që e karakterizojnë dhe e harmonizojnë jetën e njeriut. Kështu që, arsyeja e pranisë së mëkatit në botë dhe të gjitha pasojave që mëkati vazhdon të prodhojë në zemrën dhe jetën e njerëzve, assesi nuk mund ta vë në dyshim se Hyji i mishëruar në personin e Jezu Krishtit ja solli vërtet

mbarë njerëzimit dhuratën e paqes, gëzimit, harmonisë dhe dashurisë së vërtetë. Dhe jo vetëm kaq, por, tekstet e shumta biblike, të shkruara nga dëshmitar okular (apostujt), dëshmojnë qartas se vetë Jezusi është Paqja, Ai është Gëzimi, Dashuria, Rruga, e Vërteta dhe Jeta për të gjithë ata që e besojnë dhe e pranojnë për Hyj në jetën e tyre.

Pra, me plotë të drejtë i krishteri beson dhe pohon se Krishtlindja ia solli botës gëzimin, shpresën dhe jetën: vetë personi i Hyjit është bërë i dukshëm në Fëmijën e thjeshtë dhe të varfër të Betlehemit, por i pasur në dashurinë e tij për mbarë njerëzimin. Shën Ireneu rrëfente: "Biri i Hyjit është bërë njeri në mënyrë që njeriu, i bashkuar me Fjalën, të mund të pranojë adoptimin dhe të bëhet bir i Hyjit".

Prandaj, lajmi kumbues i Krishtlindjes nuk është thjesht vetëm një lajm i mirë i së kaluarës. Kremtimi i Krishtlindjes nuk është vetëm festimi i një ngjarje që ka ndodhur dymijë vite me parë, e aq më pak një paraqitje e shenjtë, që ne sot mund të realizojmë përmes shfaqjeve me tematikë të Krishtlindjes apo përmes rregullimit të 'Betlehemit'. Jo, nuk është një kujtim i zbrazët, një mallëngjim i së kaluarës, një shpikje poetike, një lojë ndjenjash. Në Kërshndellat e Jezusit lind Njeriu i ri dhe në Të ne takojmë Hyjin. Secili njeri që e pranon bëhet krijesë e re: "Sot, në qytetin e Davidit ju lindi Shëlbuesi - Krishti Zot! Sot Drita shkëlqen mbi ju. Vërtet u duk hiri i Hyjit që u sjell shëlbimin të gjithë njerëzve"; kështu na porosit liturgjia e Fjalës në kremtimin e Krishtlindjes.

Përballë kësaj dashurie të madhe të Hyjit për botën. Njeriu me plotë të drejtë mahnitet dhe njëkohësisht pyet vetveten: Çka mundë të them përballë kësaj mrekullie të dukshme dhe të prekshme? Më mungojnë fjalët: gjuha dhe goja nuk janë të afta të dëshmojnë këtë ngjarje të madhe hyjnore. Pikërisht për këtë arsye ja vlen t'i bashkëngjitëm korit të engjëjve dhe këngës së tyre: "Lavdi Hyjit në më të lartin qiell e paqe mbi tokë njerëzve, që i ka për zemër!".

I frymëzuar nga ngjarja mahnitëse e Krishtlindjes edhe Shën Augustini brohoriste: "Zgjohu, o njeri, për ty Zoti është bërë njeri!". Pra, të zgjohem! Jezusi është mishëruar: të gëzohemi! Jezusi ka lindur: ta lavdërojmë! Jezusi ka zbritur nga qielli: t'i shkojmë në takim! Jezusi është mbi tokë: ta pranojmë në zemrën dhe familjen tonë! Ky është besimi ynë, kjo është ngjarja që ne kremtojmë.

Për shumë mot Krishtlindja! Paqe dhe bekim për Vitin e Ri 2016!

Dom Nosh Gjolaj
Podgoricë

GADISHMERIA E PERHERSHME PER TA LUFTUAR E PER TA MPOSHTUR INSTIKTIN E PUSHTETIT.

(Pjesa e dytë)

1. Instinkti i lindur për ta mposhtur tjetrin.

b) Nënçmimi i instinktit posedues

Kurrë nuk është mirë ta nënçmojmë përvojën Biblike, sepse në të është e paraqitur aq bukur dhe në mënyrë dinamike drama dhe tragjedia e njeriut. Partnerët duhet gjithherë ta kenë parasysh, këtë pamje figurative të jetës, po qe se dëshirojnë jetën e përbashkët të jetë e frytshme dhe afatgjate. Njeriu si individ nuk mund ta kalojnë apo ta kapërcejnë "hijen e vet" as ta mbysin karakterin e gjarprit: instinktin, pasionin apo impulsin ato fuqitë shpërthyese e dominuese për ta pronësuar partnerin. Këtë virusin e gjarpri çdo njeri prej neve e bartë me vete, kuptohet gjithherë në format e ndryshme por zakonisht të maskuara, e shprehet në këtë apo në tjetrën mënyrë. Po qe se bashkëshortët nuk janë të kujdesshëm atëherë mund t'u ndodhin papritmas të shpërthej si vullkan energjia shkatërruese që jo vetëm se e shkatërron apo e helmon vetveten por edhe partnerin po qe se kanë fëmijë edhe fëmijën, që shumë shpejt behën fli e gjarprit apo instinktit që e terrorizon dashurinë dhe fisnikërinë e saj.

Çfarëdo propozimit, programimit, idesë apo ndonjë ndërmarrje, kurrë nuk është mirë që të bëhet pa konsultimin edhe palës tjetër. Sepse gjestet e tilla mund shumë lehtë të sjellin pakënaqësi dhe ringjalljen e impulsit sundues duke e nënshtruar apo nënçmuar tjetrin! Në këtë qëndron shpata e Damoklei-t, sepse tundimi i përhershme i njeriut është që ta pronësojnë apo ta instrumentalizojnë tjetrin në rastin tonë partnerin për ta nënshtruar atë.

Njeriu siç ishte edhe gjarpër është dinak dhe në mënyrë dinake apo perfide e impono pushtetin mbi tjetrin. Siç bie fjala: "gruaja me flokë gjata e mend pakta" e cila duhet t'i nënshtrohet mendësisë së burrit, i cili është koka e familjes, që mendon, programon, punon, po ashtu edhe rrethi gjithnjë ashtu mendon se gjinia e dobët, nuk është për asgjë tjetër përveç të kujdesohet për shtëpi dhe rritjen e fëmijës, dhe si e tillë mos të përzihet në punën e meshkujve, se nuk i takojnë asaj për të vendos. Po ashtu imponimi mund të realizohet me fjalët e bukura, të ndjeshme, të ëmbla, si bie fjala: "shpirti im, zemra apo loçka e ime, ti do ta lëshosh shkollën dhe do të kujdesohesh për shtëpi dhe për fëmijë, përderisa unë do të punoj për mirëmbajtjen e familjes etj...!" Ose mund të imponohet në mënyrë arrogante: "Ti je gruaja ime, dhe nuk të përket që të punosh më, por duhesh menjëherë ta lëshosh vendin e punës, pikë dhe këtu nuk ka diskutim!"Partneri në fjalë jo vetëm se ja uzurpon të drejtën palës tjetër por edhe manipulon me të, e shfrytëzon qoftë në emër të traditës, apo të fesë ose mendësisë së mjedisit, siç bie fjala: "ne jemi shqiptar dhe jo gjerman, zviceran apo amerikan etj.!" Atë mos të flasim për keqtrajtimin në sferën intime për ta shfryrë impulsin seksual pa ndonjë parapërgatitje dhe pa ndonjë dashuri të ngritur dhe të fisnikëruar, veç se tani i teket të kenë marrëdhënie seksuale, sepse ati i takon kjo e drejtë, pse atëherë jemi të martuar. Çka të themi për shprehitë e fjetjes apo të ushqimit, që ia refuzon ushqimin, gjoja se nuk është përgatit mirë dhe ashtu siç e do ai. Mandej mund shumë lehtë të hedhet faji tjetrës palës sepse ky ka dështuar në punë, në shkollë, në shoqëri apo në politik. Sepse partneri nuk ka bërë aq sa duhet për t'ia arrit suksesin, menjë fjalë partneri nuk ishte dora e

ngjatur për ta realizuar egoizmin. Partneri në fjalë nuk e do gruan apo anasjelltas burrin por e do veten dhe nëpër mes partnerit ta realizojnë qëllimet e veta, idealin, po ashtu mund të ndodhin edhe me fëmijë, prindi nuk e do fëmijën por e donë veten dhe nëpër mes tyre ta realizojnë dëshirat e pa realizuara, menjë fjalë fëmijët janë në këtë rast dora e ngjatur e prindit. Thjeshtë është ai virusi narsisioid që buron nga nënvetëdija (pavetëdija) për ta pronësuar tjetrin, për ta mposhtur tjetrin apo për ta shkelë duke shprehur kështu sadizmin për të cilin ishte fjala një prej takimeve të përparshme, që nuk është asgjë tjetër përveç njëfarë vartësie dhe vetëkënaqësie që buron nga sfera arkaike dhe primitive të brendisë së njeriut gjarpër. Po qe se çifti në këtë rast nuk është i kujdesshëm shumë lehtë mund të çorodite jo vetëm ai por edhe bashkësia martesore. Çka dëshmojnë ordinancat e psikiatrike e mos të flasim për perversionet e llojllojshme, apo për dhunime, terrorizime dhe tiranin e jetës së përditshme në bashkësinë martesore, që i përngjajnë një kanibalizmin të kuptimit të plotë gojës. Bile nga ky sadizëm njeriu paraqitet para tjerëve në mënyrë krenare, i cili triumfon se si e mposhti apo e shkeli tjetrin dhe e nënshtron porsi qeni gjahtar, i cili kënaqet për lepurin të varë.

Shumë bukur e përshkruar Sain - Exuperyji në librin e njohur: Princi i vogël, virusin për ta pronësuar tjetrin, nevojën për pushtet, që është e maskuar në thellësitë e shpirti dhe i përngjan bimës së një planeti, prej kah vjen Princi i vogël, dhe kjo bimë është një farë krisje apo bari i egër. Kjo bimë e keqet rritet shumë shpejt e në mënyrë të mrekullueshme, i asgjëson të gjitha bimët tjera apo gjallesat, dhe ia merr frymën e nuk i lejon për t'u zhvilluar. Përderisa vetes ia lejon zhvillimin e bujshëm thuajse i përngjan vetëtimës. Po qe se kopshti martesor nuk punohet për çdo ditë dhe nuk e pastrojnë rishtas krisjen (barin e keq) dita-ditës, atëherë kopshti i kënaqësive do të kthehet në kopshtin e ferrit apo të djallëzuar, sepse aty nuk mbretëron më dashuria dhe fisnikëria por ai bari i egër (krisja) që ia merr frymën e lirisë çdo krijesë tjetër, ai e sheh vetëm veten dhe asgjë tjetër!

Ky konstatim nuk është vetëm teori abstrakte por realitet i përditshëm që e shkatërron jo vetëm mija e mija çifte martesor por edhe lërë pas vetes pasojat e pashëruara siç janë fëmija, që rriten në frymën e këtij helmimit, gjysmak, të pa dëshiruar, të frustruar dhe mos të flasim për fatin e tyre që i pret e ardhmja!

Martesa ideale kuptohet vetvetiu se nuk ka, por ka martesa të mirë, të harmonizuara, aty ku respektohet gjuha e dashurisë, e durimit, aty ky për çdo ditë pastrohet kopshti i dashurisë nga bari i egra që e lëndojnë dashurinë, e cila është mjaft e ndjeshme dhe e prekshme. Dashuria nuk duron egoizëm, por ajo dhurohet falas dhe pranon nga tjetri dhuratën falas pa kusht. Egoizmi nuk ka vend në gjirin e saj. Po ashtu për disfata apo dëshirat e parealizueshme nuk do ta fajëson tjetrin në mënyrë naive, por në frymën e durimit dhe të ndërsjellët me shumë kujdes e pedanti ta shikojmë e ta pastrojmë barin e keq nga kopshti martesor nga brendia ime egoiste pastaj të dalim në takim me tjetrin kuptohet me gjuhën e zemrës dhe të dashurisë.

Ç'kuptim ka në rastin tonë bari i keq apo krisja, konkretisht bie fjala çifti martesor udhëton së bashku në pushimet verore në det, bie fjala në Ulqin, Durrës apo Velipojë, njërit prej tyre i grah automobilit sepse është i pasionuar në grahjen apo në vozitje, po ashtu ka njëfarë kënaqësie të veçantë, por është i lodhur e i flihet përpara timonit, ashtu u kërcënohet vdekja nga përplasja në humnerë apo greminë. Partneri që është përskaj ka për detyrë për ta qortuar në mënyrë njerëzore: “I dashur ose e dashur, e dijë se e ke në qejf timonin por kuptoj je i lodhur dhe i pa gjumë, por tani pusho pakë, për ndryshe jeta jonë është në rrezik!” Po qe se partneri tjetër di t'i grahin automobilit, atëherë ai duhet ta marrin timon në dorë. Po qe se i kthehet vëmendja qortues në mënyrë urdhëruese sigurisht refleksi mbrojtës dhe egoizmi i brendshëm reagon në mënyrë të furishëm dhe armiqësore: “shuaj e mbylle atë gojë, për inatin nuk do ta jap timonin!” Është shumë e rëndësishëm takti dhe metoda, si fillohet biseda apo dialogu, që është domosdoshme mirësjellja dhe durimi për ta dëgjuar tjetrin deri në fund, po ashtu edhe orvatja për ta kuptuar dhe çka fshehte pas fjalëve pohuese apo mohuese: “I dashur apo e dashura edhe ti ke të drejtë për ta shpreh mendimin deri në fund!” Kuptohet nga çdo partner të mundohet sa më qartë dhe thjeshtë, të definuar mirë dhe të artikular mirë, që të jetë i qartë dhe i kuptueshëm. Ndoshta është mirë për njeriun e frustruar apo të ngarkuar nga e kaluara, ta përdor edhe ndonjë anekdotë apo shembull tërheqëse, por jo deri në fund, por deri sa fillon t'ia arrin efektin, se çka ndodhi apo si përfundoi ndodhia, ti do të përgjigjesh thjeshtë: "Pjesën e tjetër do ta them më vonë!" Sepse fuqitë djallëzore duhet të demaskohen sa më shpjet dhe në qoftë se partneri i uritur nuk vjen për të ngrënë prej principit, se gjoja i paska thënë ashtu dhe pikë: “buka duhet të shtrohet vonë”, sepse

ai ka thënë ashtu! Që nuk është asgjë tjetër përveç mizat e gjarprit apo ai bari i egër që e sulmon kopshtin e dashurisë! Shembujt e tillë siguristh janë të panumërta po ashtu janë të panumërta veset poseduese apo bari i egër që duhet dita-ditës për t'i mposhtur.

Nganjëherë ndoshta na kaplon gjumi i kënaqësisë martesore dhe nuk vetëdijesohemi për gjarprin i cili qëndron në thellësinë e qenies njeriut, i cili gjithherë do ta gjejë dobësitë e njeriut ku do ta kafshojë, nganjëherë një kafshim i tillë mund të jetë fatal dhe vdekjeprurës për kopshtin martesor.

Individi në jetën e përditshme është në kundërthënie me vetveten. Nganjëherë ai të merr në gryk e të përqafon, të përkëdhel apo të ledhaton por nga ana e tjetër fillon të lajmërohet instinkti i posedimit ajo uria djallëzore, e cila ia rrëmben njeriut dhe çdo individit fisnikërinë, dashurinë dhe atë më të mirë që e posedon e papritmas hyrë në vorbullën e fuqive poseduese, egoiste, shfrytëzuese për ta shkelur jo vetëm partnerin apo shokun e martesës me të cilin e nda dhuratën e dashurisë por edhe e ia merr frymën krijimtarisë, lirisë dhe të bukurisë. Si bie fjala partnerët janë në dhomën e ditës në të cilën gjendet edhe televizori. Pikërisht përpara ekranit të televizorit mund lehtë të dalin në skenë ai bari i egër dhe pronësues që ia rrëmben lirinë dhe përcaktimin e lirët tjetrit, duke imponuar programin tim, të cilin unë dëshiroj ta shikoj pa marrë parasysh dëshirat e tjetrit, në rastin tonë të partnerit, i cili nuk është dakord për një program të tillë, bie fjala loja e topit: Shqipëria e Gjermania por propozon programin edukativë mbi jetën e kafshëve të egra në Afrikë. Çifti një fjalë posedon vetëm një televizor, dhe në këtë rast nuk është me mend dhe as nuk është mirë po qe se njëra palë i nënshtrohet qejfit të tjetrit. Por zgjedhja më e mirë do të ishte për çiftin martesor në këtë rast: shorti, duke hell një monedhë në ajër! Pjekuria martesor si njërës ashtu edhe tjetrës palë shprehet po qe se ata dy akordohen për programin cilësor. Si bie fjala vlerë më të madhe ka ndonjë dramë nga klasikët greke sesa festivali i këngëve apo zgjedhja e misit shqiptar e mos të flasim për një lojë të futbollit. Sepse e para e ngrit, e fisnikëron, kultivon kulturën e zemrës, qytetërimin, ia zgjeron horizontin, ia kalit karterin, kontribuon në rritjen e cilësisë së jetës të njeriut, përderisa e dyta vetëm e argëton dhe në fund e lëshon njeriun të zbrazët pa ndonjë ushqim shpirtëror!

Në rastin e dytë, i cili prej partnerëve ka përparësi ta punoi atë punë që nuk i flenë në zemër ndoshta edhe i gërditet, por është detyrim e njëherë barrë si për njërin ashtu dhe për tjetrin, si bie fjala të pastrohet shtëpia. Po ashtu edhe në këtë radhë është mirëseardhur shorti, se sa të arritët konflikti apo të urdhërohet palës tjetër. Sepse urdhëresa e mos toleranca e ringjallin instinktin sundues, pushtues dhe robërues që sjellë jo vetëm pakënaqësi por çiftin e shpie në vorbullat djallëzore që nuk kanë kthim mbrapa por shkon kah zhdukja jo vetëm individit por edhe bashkësisë martesore (rezignacionin total, që nuk është asgjë tjetër përveç dorëzimi i dikujt apo fatit, ose nënshtrim i dikujt dëshirës së partnerit, ose pajtim me fatin ose prapë indiferencë e plotë).

Me tjera fjalë egoizmi apo narsioizmi është kërcënimi i përhershëm i çdo martesës dhe fatulmturisë së saj. Jo vetëm se e asgjëson dashurinë por e tjetërson personin dhe e zhveshur nga dinjitetin e unikatit që e posedon çdo njëri prej neve. Po qe se është njëri prej çiftit martesor edhe i sëmurë nga sëmundjet recidive që nuk është asgjë tjetër përveç rishfaqje ose përsëritje e një sëmundjeve, kthimi i sëmundjes në rastin tonë instinktit posedues apo egoizmit vetjak. Ai si i tillë menjëherë e mashtron tundimi posedues dhe hyrë në rrethin

magjik pa ndonjë bisedë apo dialog me palën tjetër. Ai si i tillë e sheh vetëm veten, interesin, vet realizimin, nga natyra tipi i tillë është mjaft përtac apo i plogësht, që i rikujtohet menjëherë edhe mekanizmi mbrojtës, që jo vetëm do ta fajësojnë partnerin por edhe do ta sulmojnë ndoshta edhe fizikisht.

Harmonia e çiftit martesor ndahet në dy gjysma të armiqësisë, njëra kundra tjetrës duke u manifestuar në mënyrë të dhunshme. Shpëtimi është vetëm në vetëdijesimin e plotë të çiftit, për ta mposhtur instinktin apo egoizmin ose ata "barin e keq" nga bota e brendshme të njeriut, e cila nuk asgjësohet njëherë e përgjithëson por duhet ditaditës të luftohet dhe të orvatet për ta mposhtur këtë tundim të përhershëm. Përndryshe gjithherë është në rre rrezik jo vetëm individi si i tillë për t'u asgjësuar apo tjetërsuar duke u shkrirë në mall konsumues por edhe asgjësimi i bashkësisë posaçërisht i dashurisë dhe fisnikërisë, në të cilën çifti ka investuar aq shumë e munde për krye nate ta humbë dhe të bankrotoi. Për këtë arsyer është e domosdoshme tundimin e pronësues apo instinktin e tillë të ngujohet në zinxhirët e hekurt dhe far mos t'i lejohet të marrin frymë lirishtë, po qe se dëshirojmë ta aktualizojmë dhe ta realizojmë fisnikërinë njerëzore, dashurinë, fatlumturin e afatgjatë, menjë fjalë për t'i realizuar ëndrrat e jetës.Vigjilenca dhe preventiva janë gjithherë të mirëseardhur dhe kumbarët e mirë të dashurisë. Çdo lloj gufimit, të cilët shpërthejnë papritmas nga brendia ose nga nënvetëdija e njeriut janë jo vetëm shkatërrues por edhe vdekjeprurëse për bashkësinë e harmonizuar. Instinkti sunduese apo pronësues i përket sferës biologjike apo të kafshës që gjinden në çdo njeri pa marrë parasysh gjini, kombi, civilizimin, ngjyrë, rasën apo kohen ose vendin. Individi mund të jetë i suksesshëm vetëm po qe se është realist dhe e njeh veten dhe karakterin apo temperamentin e vet mirë. Sepse instinkti i tillë është ai gjarpër që duket se ka vdekur por nuk është e vërtetë se vetëm lëkurën që e ka lërë pas është e vdekur por ai del me lëkurën tjetër dhe është i pavdekshëm, e gjithherë i gatshëm që ta godasin njeriun në atë pikën e dobët, posaçërisht vlen edhe për bashkësinë martesore! Kuptohet se çdoherë rishtas duhet të mposhte ky gjarpri i vjetër posedues dhe hedhës i helmit vdekjeprurëse, për këtë duhet ta kemi edhe ndihme e ndërsjellët të partnerit dhe të mjedisit. Kjo ndihmë nuk do të thotë se duhet çifti martesor ta përdorin zmadhuesin apo me ndonjë zhurmë të madhe ose me ndonjë buri ta qesin përpara vetes për ta dëbuar djallin posedues prej partnerit. Gjoja se jemi në bashkësinë martesor dhe partneri ka të drejtë dhe është i autorizuar prej shtetit ose kishe për këtë veprim! Një qëndrim i tillë është i gabueshëm dhe nuk duhet të ketë vend në gjirin martesor. Por kuptohet duhet të kenë një kujdes dhe ndjeshmëri të veçantë ndaj tjetrit për të mos të lëndohet dashuria, njerëzia, fisnikëria. Çdo njeri gabon dhe është i papërsosur, shenjtëria, dashuria dhe fisnikëria nuk lindin por gradualisht arritën gjatë jetës, duke u orvatur për to. Sepse një gjest i pamenduar mirë dhe jo në vend mund të shkaktojnë jo vetëm lëndime por edhe pasoja vdekjeprurëse për harmonin dhe fatlumturin e çiftit martesor. Po ashtu nuk është arë gjithçka që shkëlqen është një fjalë e vjetër!

c) Pushteti djallëzor

Çifti martesor gjithherë duhet të ketë një kujdes të veçantë ndaj tjetrit dhe njëherë të gjitha ndërmarrjet duhet të ecin në drejtimin e dy pyetjeve rrënjësore, siç është pronësomi apo pushteti djallëzor dhe varësia nga tjetri:

1) "Pushteti djallëzor", çifti martesor duhet të vetëdijesohet dhe ta mposhtin gjithherë dhe kurdoherë instinktin për ta nënshtruar tjetrin apo të manipulosh me tjetrin për ta realizuar vetveten apo aspiratat egoiste pa tjetrin. Gjithherë çifti martesor duhet t'i analizojnë sjelljet veta dhe aspiratat qofshin ato të vetëdijshme apo të pavetëdijshme. Për të hyrë në botën e dashurisë, në botën e lirisë dhe të fatlumturisë, duhet njeriu të motivohet, për ta forsuar vullnetin e fortë, shprehia e punës dhe angazhimit fizik dhe shpirtëror. Për t'ia arrit qëllimin duhet ta posedosh strategjinë dhe njëherë armen për ta realizuar projektin. Në këtë mënyrë zvogëlohet mundësia e pushtetit djallëzor të mbretëroi në gjirin familjar!

2) Përpos pushteti djallëzor apo pronësues në njeriun është edhe tundimi i tjetër, që partnerin e bëjmë te varur. Ashtu pushteti djallëzor mund pas një kohës së gjatë ose pas një fazës së shkurt ose pas një luftës të brengosur të kalojë prej duarve të njërit në duart e tjetrit në cilën fushë do të mbesin shumë gjëra të paqarta. Por e qartë është se në atë bashkësi do të reflektojë pushteti i punës nëpër mes të cilës e bëjmë të varur at tjetrin, sepse nuk posedon mundësin materiale për të qenë i lirë po varet pikërisht prej atij që punon. Kuptohet një qëndrim i tillë sjellë jo vetëm lëndime por edhe plagët të pashërueshme që është në dëm të dashurisë, të bashkësisë dhe të lumturisë së përhershme martesore.

Zakonisht impulsi sundues vepron në mënyrë tinëzake dhe nganjëherë ngadalë ngadalë, herë pas herët me kafshime të reja derisa pushteti djallëzor i tregon dhëmbët, që nuk është asgjë tjetër përveç ftohja, ngurruar dhe largimi njëri prej tjetrit në jetën e përditshme martesore. Shenjat e tillë paralajmërojnë se martesa apo bashkësia martesore gjinden në krizë ose para shkatërrimit. Për bashkëshortit e kuptueshëm apo të arsyeshëm ata menjëherë e kuptojnë situatën dhe ndërmarrin shërimin e saj duke e mposhtur pushtetin tiranik apo djallëzor që shprehet tinëzisht në gjirin e tyre, që nuk është asgjë tjetër përveç ta mposhtësh tjetrin apo të dominosh ose fjala e jote duhet të respektohet. Kuptohet vetvetiu se jeta e përbashkët dhe bota e intime e dashurisë nuk duron pronësi as dhunë edhe më pak imponim, por sa nuk është vonë duhet të mposhtet instinkti apo impulsi sundues apo egoist dhe të përjashtohet nga oborri martesor. Duke armatosur me fe, shpresë dhe dashuri, që nuk është turp as poshtërim t'i pranosh tjetrit suksesin, mendimin, propozimin, qortimin apo këshillin. Fleksibiliteti është i mirëseardhur për jetën e përbashkët. Individi gjithherë duhet të pajiset me një humor të shëndoshë, me optimizëm e shkathtësi vitale, e cila jo vetëm se jep jetë dhe freski bashkësisë martesore por edhe i shëron plagët e krijuar nga pakujdesi gjatë rrugës së jetës së përbashkët.

Në rastet e shumët gruaja nuk është fare e vetëdijshme deri sa larg mund të shkoi keqpërdorimi i pushtetit egoist e djallëzor në rrethin familjar. Shumë bukur e paraqet anekdota si vijon më poshtë mendësinë e problematikës në fjalë. Gazetarët e pyesin gruan e martuam: se si i ndani rolet dhe kush prej partnerëve vendos për gjërat e rëndësishme dhe kush për gjerat e vogël? Gruaja u përgjigjet: "Në gjërat e vogël vendosi unë si grua, ndërsa në gjërat e mëdha vendos bashkëshorti si burrë." Gazetari e shtron pyetjen tjetrën: “çka ju nënkuptoni, për gjërat e vogla dhe të mëdha?” Ajo përgjigjet: "Në qoftë se na duhet automobili i ri, atëherë vendosi unë, gjithashtu vendosi unë në qoftë se shkojmë së bashku në pushime ose në ushtime, unë e caktoj vendin dhe kohën, edhe gjithashtu unë vendosi për mbi ekonomin dhe buxhetin e shtëpisë edhe në çka dhe se sa kemi mundësi të shpenzohet. Të gjitha këto janë për mua gjëra e vogla. Ndërsa burri vendos për gjërat e mëdha, si vjen fjala në pjesëmarrjen e kuvendit në Kombeve të Bashkuara, ai voton ose propozon: a duhet ushtria shumëkombëshet të vijë në Shqipëri? ose do ta vazhdojnë luftën në Bosnje? siç i shihni këto janë gjërat e mëdha e për këto vendos bashkëshorti, të cilit nuk i përzihem në punët e tija!"

IMZOT RROK MIRDITA PËRCILLET ME NDERIME PËR NË BANESËN E FUNDIT (1939-2015)

TIRANE- Qindra besimtarë katolikë, përfaqësues të Kishës Katolike, të politikës dhe trupit diplomatik kanë marrë pjesë në homazhet e zhvilluara në Katedralen e "Shën Palit" në nderim të Imzot Rrok Mirditës, i cili u nda nga jeta me 7 dhjetor të këtij viti. Krerët më të lartë të shtetit, si Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, Kryeministri Edi Rama i shoqëruar nga bashkëshortja e tij, Linda Rama, kryetari i PD-së Lulzim Basha, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, Kryepeshkopi i Kishës shqiptare ortodokse, Janulatos Anastas, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Baba Mondi, dhe përfaqësues të besimeve të tjera fetare, politikanë e përfaqësues të trupit diplomatik në Tiranë etj., morën pjesë në homazhet e zhvilluara me 9 dhjetor në ambientet e Katedrales.

"Ne sot ndajmë dhimbjen e thellë, por dhe respektin e madh dhe përuljen ndaj këtij prelati të lartë për përkushtimin e mahnitshëm dhe shërbimin e jashtëzakonshëm që i bëri vlerave të krishterimit në radhë të parë, por dhe për shembullin e jashtëzakonshëm

që ofroi në ndërtimin dhe udhëheqjen e bashkësisë së krishterë gjatë gjithë kohës", u shpreh kreu i shtetit.

Pas homazheve me 10 dhjetor 2015, është zhvilluar Mesha e funeralit për përcjelljen në banesën e fundit të Imzot Mirditës, drejtuar nga Imzot Ramiro Molinar Ingles, Nunci Apostolik në Shqipëri. Predikimin e mbajti Imzot Gjergj Frendo Ipeshkëvi ndihmës, ndërsa salikimi dhe përshëndetjet e fundit te varri janë bërë nga Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafra, kryetari i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë dhe Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër – Pultit.

Imzot Rrok Mirdita u nda nga jeta tri ditë më parë pas një hemorragjie cerebrale në moshën 76-vjeçare. Kisha Katolike shqiptare, përkatësisht, Kryedioqeza Tiranë-Durrës, humbi një përfaqësuesit denjë të saj i cili për 22 vite me radhë qëndroj si kryebari në shërbim të Zotit dhe popullit.

MIRDITA, IMZOT RROK (1939 – 2015)

Imzot Rrok Kolë Mirdita, lindi më 28 Shtator 1939, në Kllezën të Ulqinit, Mali i Zi. Mësimet fillestare i kreu në vendlindje Katerkollë, ndërsa të mesmen në Zarë të Kroacisë (1954-1959). Studimet e larta filozofike dhe teologjike i kreu në Fakultetin Teologjik në Zagreb ku u diplomua. Më 4 korrik 1965 shugurohet meshtar nga Shkëlqesia e Tij Aleksandër Tokiq, Arqipeshkëv i Tivarit. Nga vitit 1966- 1969 shërben në famullin e Salcit dhe të Bratices. Më 1970 emërohet famullitar i Kishës së Shën Gjon Pagëzuesit në Kllezën. Me dëshirën e tij, nga arqipeshkvi i Tivarit, Aleksander Tokiq, lejohet të shkoj në New York , si ndihmës i Mons. Zef Oroshit, për t'i shërbyer diasporës katolike shqiptare në Bronx, në Kishën "Zoja e Këshillit të Mirë" në vitin 1973. Në marrëveshje me Kryedioqezën e Tivarit, Eminenca e Tij Terence Kardinal Cooke, Arqipeshkëv i New York-ut, me dekret të datës 19 qershor 1982, e pranon si meshtar me shërbim të përhershëm në këtë Arkidioqezë me detyrë të ndihmësit pranë qendrës "Zoja e Këshillit të Mirë". Në vitin 1985 themelon radio programin fetar "Zëri i Kishës Katolike Zoja e Shkodrës" për New York-un e rrethe, program të cilin e vazhdon për shtatë vite me radhë. Më 1 korrik 1986 Hirësia e Tij Kardinal O'Connor – Arqipeshkëv i New York-ut e emëron Administrator të Kishës Katolike Shqiptare "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe me pas famullitar.

Më 25 prill 1993 kur Papa Gjon Pali II vizitoi Shqipërinë dhe shuguroi 4 ipeshkvij, mes të cilëve Imzot Rrok Mirditën, fillon misionin si Arqipeshkëv i Durrës-Tiranës. Pos riorganizimit të jetës fetare në këtë kryedioqezë ia nxiti dhe ndërtimit të shumë objekteve fetare si dhe ndërtoi Katedralen e Shën Palit në Tiranë e cila u inaugurua në vitin 2002. Në disa mandate ka kryer detyrën e Kryetarit të Konferencës Ipeshkvore të Shqiptarisë. Më 25 janar 2005, Papa Gjon Pali II i dha kësaj selie kryeipeshkvore titullin "Argjipeshkvia Metropolitane Tiranë-Durrës". Vdiq me 7 dhe varros me 10 dhjetor 2015 në kriptën e Katedrales në Tiranë.

Dom Nikë Ukgjini

Don Lush GJERGJI
Prishtinë

CHARLES DE FOUCAULD – Dialogu ndërfetar në veprim (1858 – 1916)



"Mos grumbulloni për vete thesare mbi tokë, ku i brejnë tenja e ndryshku, ku vjedhësit birojnë muret e vjedhin! Mblidhni për vete visare në qiell, ku s'brejnë as tenja as ndryshku e ku vjedhësit nuk birojnë mure as nuk vjedhin. Sepse, ku është visari yt, aty do të jetë edhe zemra jote."

(Mt 6, 19-21)

"Dëshiroj të jetoj ngjashëm Jezusit në Nazaret, vetëm nga puna e duarve të mia, pa marrë ndonjë ndihmë apo dhuratë, pa kurrfarë pasurie. O, po të kisha mundur të themeloj një Bashkësi të vëllezërve të Vegjël, e cila po ashtu do të jetonte në grupe të vogla".

Charles De Foucauld

Charles de Foucauld, u lind vitin 1858 në Strasburg, në një familje të pasur bujare nga prindërit Eduard dhe Elizabetë. Kishte edhe një motër e cila quhej Mari. Në moshën gjashtë vjeçare mbeti bonjak dhe iu besua kujdesit të familjes së ëmës, familjes Morlet. Vdekja e prindërve, atë e bëri të padisiplinuar, agresiv, dembel në shkollë dhe në jetë, nervoz, të pikëlluar, të ngutshëm, shpeshherë edhe të paqetë. Si t'i besohet Zotit kur ai është aq i padrejtë? Ishte kjo pyetje dramatike e cila u lind në brendinë dhe shpirtin e parehatshëm të një personi të ri.

Duke shqyrtuar rininë, ai e pranon: „Deri në moshën 12 vjeçare unë nuk kam njohur as besuar në Zotin, isha i palumtur dhe as që mund të lejoja ekzistencën hyjnore… Në moshën 16 vjeçare isha plotë egoizëm, krenari, mosbesim, isha i prirë ndaj të së keqes…Në zemrën time nuk kishte më kurrfarë gjurmë të besimit."

Studioi, mirëpo pa vullnet dhe angazhim, edhe pse ishte shumë i talentuar. U regjistrua në Akademinë Ushtarake. Mirëpo, me karakterin e tij duket se ishte e pamundur të harmonizohet me rregullat dhe jetën e Akademisë. Si nënoficer, kërkoi dhe mori leje që të shërbente në Algjeri. Mirëpo, edhe atje ishte njësoji: i paangazhuar, jashtëzakonisht i padisiplinuar, shpeshherë agresiv, aspak i përshtatshëm për detyrë ushtarake. Pikërisht për këtë, edhe u kthye shpejt në Francë. Nga kjo përvojë e hidhët erdhi deri te përfundimi: „Unë jam i mjerë dhe njeri i shkatërruar!"

Lufta në Algjeri

Pas pak kohe në Algjeri shpërtheu lufta dhe miqtë e tij luftonin kundër kryengritjes popullore. Duke menduar mbi këtë, ai vendosi të kthehet në Algjeri, për të luftuar së bashku me ushtarët francezë. Dhe mori lejen.

Me këtë kthim, dukej vërtet se ishte tërësisht njeri tjetër, serioz, i angazhuar, i rregullt, i përgjegjshëm, i gatshëm për bashkëpunim me të gjithë. Në luftë për pushtimin e mëtutjeshme të Afrikës për shakë të kolonizimit, Charles tashmë është tërësisht tjetër ndaj shokëve të tij. Mendonte, nderonte popullatën vendore, traditat e tyre, bile do të dëshironte edhe ai të jetojë sikur ata, të jetë i afër vendorëve.

Ja dëshmia e tij: „Dëshiroj ta njoh më mirë Afrikën. Kam parë dhe takuar shumë gjëra të reja e të mira, si për shembull heroizmin, aftësinë e popullatës për vuajtje, për ballafaqim me realitetin e hidhur dhe të rëndë. Është një gjë të cilën unë nuk e kam: Besimin në Zotin. Arapët besojnë thellë në Zotin, e përjetojnë praninë e tij, lutën, dëshirojnë të jetojnë me Të; edhe unë do të dëshiroja që t'i kuptoja më mirë. Më nuk më intereson Algjeri, të cilin e njoh mjaft mirë, por Maroko-ja misterioze dhe e panjohur".

Në pafundësinë e shkretëtirës

Për të pasur mundësinë e njohjes më të mirë të vendorëve, ai filloi studimin e gjuhës, kulturës dhe traditave të tyre. Për të hyrë sa më mirë në realitetin shoqëror të Marokos, kishte vetëm dy mundësi: ose të paraqitet si shtegtar islamik, ose si hebre, gjithsesi me ndihmën dhe përkrahjen e hebrenjve të atjeshëm. Pikërisht për këtë arsye u shoqërua me një rabin hebrenj me emër Mardok në „aventurën" e njohjes së kulturës dhe popullit maroken.

Charles de Foucauld udhëton shumë për të njohur të gjitha dhe për të arritur përvojën e drejtpërdrejt. Shënoi të gjitha vërejtjet dhe zbulimet e tija dhe mendoi thellë mbi to, kërkoi vetveten. Këto përvoja i publikoi në librin: Njohuritë e reja rreth Marokos, ku përshkruan se si e përjetoi këtë botë 11 vjeçare të jetës dhe punës me njerëz (1883-1894). Shkretëtira dhe bota islamike pa ndërpre e ngacmonin dhe inkurajonin.

Hulumtuesi Charles de Foucauld, në këtë dëshirë për të njohur risinë, për të zbuluar, vërtet ai kërkoi vetveten, identitetin e tij, jetën; në pafundësinë e shkretëtirës, në popull, kërkoi gjurmët e Krijuesit. Në dëshpërim kërkoi besimin, sepse ishte i palumtur, i vetmuar, i pafuqishëm, pa Zotin, asgjë dhe askush.

Kushërirës së vet i tha: "Ti je e lumtur dhe e kënaqur, sepse beson. Unë kërkoj dritën, por nuk nuk mund ta gjej." Edhe pse nuk beson ai lutej kështu: „Hyji im, nëse ekziston, më lejo të të njoh!"

Ky „Aventurist i Hyjit", vazhdon kërkimin, nuk dorëzohet, nga njerëzit e thjeshtë mëson artin e mundimit, qëndrueshmërinë, pritjen, mëson të jetë i vogël, i përvuajtur, i thjeshtë.

Në Paris, njohu meshtarin e mirë dhe të kuptueshëm atë Huvelin-in, i cili i ndihmoi dhe përkrahu në këtë kërkim. Një ditë, pas takimeve dhe bisedave të shumta, Charles u drejtua te ati Huvelin, të cilit i tha: "Erdha te ju për të mësuar. Atë, më ndihmoni, sepse unë dëshiroj të besoj, mirëpo nuk po ia mundëm!" Meshtari e dëgjoi me vëmendje e më pas me dashuri i thotë: „Ulu në gjunjë, rrëfeju. Atëherë do të besosh!"

Charles bëri ashtu siç i tha miku Huvelin, u rrëfye pas shumë e shumë viteve dhe me këtë liroj barrën nga zemra dhe qetësoi ndërgjegjen. Nga kjo ditë Hyji e tërhiqu gjithë e më tepër.

Pas shumë vitesh të të menduari dhe lutjesh vendos të bëhet rregulltar. Në vitin 1890 bëri edhe hapin e parë, shkroi lutjen për t'u pranuar në bashkësinë e trapistëve, ku në mënyrë radikale jetohet varfëria ungjillore, në përkushtimin të plotë ndaj lutjes dhe jetës shpirtërore, në dorëzimin e tërësishëm të Hyjit. Gjithë pasurinë e tij ia la motrës Marisë.

Nga kuvendi i trapistëve Charles i shkroi kështu motrës së vet: „Kurrfarë zhurme e jashtme nuk depërton këtu: vetmia dhe qetësia më ndihmon që të ndihëm mirë me Hyjin tim. Koha e ime ndahet në lutje, në lexim të përshpirtshëm dhe punë fizike, kështu për të qenë i ngjashëm Jezusit dhe për të jetuar në shoqërinë e tij…"

Në brendinë e tij, ndiente nostalgji për shkretëtirë, për popujt e varfër të cilët e pritnin. Vuajti dhe për çdo ditë ia paraqiti vuajtjet e tija Zotit. Më vonë, mori vesh se edhe në Siri ekzistonte bashkësia e trapistëve. Viziton Tokën e Shenjtë për ta pasur mundësinë që edhe më për së afërmi të jetë me Jezusin, edhe atë duke „ecur" hap pas hapi me Të me dëshirën e madhe që t'i përngjajë në gjithçka. Nga emërorët e vet kërkoi që të transferohet në Siri, në shkretëtirën Akbes.

Thirrja Hyjnore

Në shkretëtirë edhe më tepër e thellon thirrjen hyjnore. Zellshëm përfundon rishtarinë dhe vazhdon studimet teologjike.

"Më tërheq shumë teologjia, mbi të gjitha Shkrimi Shenjt. Mirëpo, këto studime nuk kanë kurrfarë vlere për të jetësuar varfërinë, flijimin, për të pasur mundësi t'i përngjajë sa më tepër Jezu Krishtit."

Pas dhënies së kushteve rregulltare edhe më tepër u bind se Hyji po e thërret në varfërinë e plotë dhe vetminë e shkretëtirës. Mirëpo, këto dëshira nuk mund t'i arrinte pa lejen e eprorëve.

Eprori Alberik-Maria, i shkroi eprorit të përgjithshëm të trapistëve në Romë, duke ia paraqitur dëshirat dhe lutjen e tij. Gjenerali u pajtua me këtë, mirëpo para kësaj vëllai Charles duhet t'i përfundonte studimet e teologjinë në Universitetin Papnor të Gregorianës në Romë. Ai këtë e bëri me angazhim dhe dashuri të madhe, kështu që suksesshëm dhe me kohë i përfundoi studimet teologjike. Pas kësaj ai një kohë u tërhoq në Nazaret, që nëpërmjet uratës dhe studimit të ndiqte Jezusin. Këtu edhe shkroi "Rregullat e vëllezërve të Vegjël të Jezusit" për ata të cilët do të dëshironin në tërësi t'i kushtoheshin Hyjit në varfërinë e skajshme dhe në vetminë e plotë.

Në vitin 1910 u shugurua meshtar. Dëshira e tij ishte që ta quanin Vëllai i Vogël Charlesi i Jezusit. Përsëri u kthye në Algjir. E shtynte gjithnjë ideja për një bashkësi. "Dëshiroj ta themeloj një bashkësi të vogël në fshatrat e varfra. Do të jetojmë nga puna e duarve tona, duke u përkulur dhe adhuruar përjetshëm të Shenjtërueshmin Sakrament. Nuk do të kërkojmë lëmoshë, as nuk do të predikojmë, por do të jemi gjithnjë të gatshëm të pranojmë çdokënd që troket në derën tonë, miqtë dhe armiqtë, të krishterët dhe myslimanët."

Mori me vete disa libra dhe një tendë të thjeshtë,

për të pasur mundësinë e të jetuarit në shkretëtirën e Saharës.

Dëshira dhe qëllimi jetësor i tij ishte: t'iu ndihmoj dhe të jetë pranë e në shërbim ushtarëve francezë, atyreve të cilët nuk kanë kurrfarë mbështetje shpirtërore, dhe t'iu bëjë mirë të gjithë banorëve myslimanë. Në Beni-Abbesu, oazë të gjelbër në mes të shkretëtirës, vendos tendën e tij si beduinët, një kishëz, një dhomzë për vëllezër, dhe një dhomë për mysafirë.

Ky vend së shpejti u bë vend qendror i takimeve shpirtërore për shumë ushtarë, por edhe për të tjerë, në veçanti për banorët vendor. Vëllai Charles i shkruan motrës së vet Marisë: "Jeta ime është e mbushur me uratë dhe mirëpritje…, ndonjë oficer, shumë ushtarë, arapët e shumtë, shumë të varfër të cilëve iu dhuroj gjithçka kam…

Do të dëshiroja që të gjithëve t'iu jam vëlla, të krishterëve dhe myslimanëve, hebrenjve, paganëve, vëlla i përgjithshëm. Kjo shtëpi quhet 'zubia', që to të thotë vëllazëri…"

Ishte i afërt për të gjithë, lutej për të gjithë, i deshi të gjithë. Udhëtoi në pjesët e ndryshme të Marokos, ku miliona e miliona njerëz jetojnë pa meshtar, pa Eukaristi.

Shpejt i humbi tre miqtë e mëdhenj që kishte: vdiq ipeshkvi i Saharës mosn. Guerini, në Francë; pastaj vdiq edhe atë Huvelin-i, gjersa nënkoloneli Papperrine definitivisht u kthye në Francë. Charles ndihej i vetmuar, dhe si njeri vërtet edhe ishte i vetëm, mirëpo gjithë e më afër Jezusit në Eukaristi. Shumë njerëz e çmonin për trimëri, mirëpo askush s'e ndoqi shembullin e tij ungjillor.

Vëllai i të gjithëve

Gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore, vuan shumë për arsye të luftës së shumë popujve mes veti. Ai, dëshiron të jetë shenjë dhe dëshmitar i dashurisë hyjnore ndaj të gjithë njerëzve, të vdes sikur kokërr e grurit për të dhënë më pas fryte të mira, që në një mënyrë me flijimet e tija t'i përgatiste botës një të ardhme të lumtur.

Në vitin 1913 në testament shkruan: "Dëshiroj të jem i varrosur aty ku vdes, që aty të pres ringjalljen…Varri im duhet të jetë krejt i thjeshtë, pa kurrfarë përmendoreje, vetëm me kryq të drurit…"

Pas flijimeve të shumta, durimit të madh dhe varfërisë, vetmisë-shoqërimit me Jezusin, tanimë ishte i pjekur për martirizim. Disa fanatik islamik nuk e duruan dot më. Vendosin ta vrasin. Si kurth e zgjedhin paraqitjen në trajtën e postierit. Hyn brenda në shtëpi, e rrahin deri në përgjakje duke e përplasur për toke dhe duke e munduar në mënyra të ndryshme. Një nga ata bërtet: „Heq dorë nga feja jote, i pafe!"

Vëllai Charles i Jezuit tha thjesht: "Po, dëshiroj të vdes, Jezu im!"

Në mënyrë barbare, me gjakftohtësi dhe me urrejtje u gjymtua para syve të Pavle Embareka-s, vëllait të Charles-it.

Fara ra në tokë të mirë dhe pjellore, dhe pas shumë viteve shembulli, gjaku, jeta e vëllait Charles u bë e pranishme në shumë pjesë të botës, sidomos përmes Vëllezërve të Vegjël të Jezusit si dhe Motrave të Vogla të Jezusit.

Jetë e investuar dhe shfrytëzuar mirë me dëshirë që t'i afrojë të gjithë kah Hyji, që t'iu jetë të gjithëve vëlla, sipas shembullit të Jezusit, në veçanti botës myslimane.

Nga jeta dhe shembulli i vëllait Charles shprehet dhe na dhurohet dëshmia e forcës dhe fuqisë së varfërisë së krishtere, jo më si domosdoshmëri dhe kusht i jetës dhe punës, por si përcaktim i dashurisë ndaj Hyjit dhe ndaj të varfërve. Vetmia shndriti në të si mundësi lutjeje dhe dashurie ndaj të gjithëve. Të zbulosh në tjetrin vëllain, motrën, të kërkosh dhe krijosh bashkimin në dallime, apo si do shprehet vëllai Charles "vëllazërinë e përgjithshme", ishte jeta dhe ideali i tij. Ai ishte, po edhe më tepër sot është, dhe udhëtregues i saktë dhe i qartë për të gjithë ne.

Vdes, qe i vrarë për shkak të urrejtjes, mirëpo ai i donte të gjithë, bile edhe vrastarët e vet. Në rerën e Saharës, është e shënuar me dashuri, me gjak martirizues një histori e bukur, një dashuri e krishterë autentike për të gjithë. Disa momente para martirizimit vëllai Charles shkroi këto fjalë: "Shkatërrimi ynë është mjeti më i fuqishëm të cilin e kemi si mundësi për t'u bashkuar me Jezusin dhe për t'u bërë mirë vëllezërve…Kryqin të cilin na dërgon Hyji është ai të cilin më së paku e kuptojmë…".

Vëllai Charles është gjallë dhe i pranishëm, veprues përmes Vëllezërve dhe Motrave të Vogla, të cilët dëshirojnë ta ndjekin atë besnikërisht, trimërisht dhe këmbëngulësisht: "Merre si qëllim jetën të cilën e jetoi Jezusi në Nazaret, në përgjithësi dhe për të gjithë, në thjeshtësinë dhe gjerësinë e saj… Si për shembull, jo të bartësh ndonjë veshje të veçantë; sikur Jezusi në Nazaret; jo të marrësh ndonjë shtëpi larg vendit, porse krejt afër fshatit; sikur Jezusi në Nazaret; asnjëherë më pak se tetë orë pune, (punë fizike apo mendore), sipas mundësisë punë fizike: sikur Jezusi në Nazaret; varfëri të skajshme, në gjithçka: sikur Jezusi në Nazaret…"

Vetëm dashuria mund t'i lirojë të pasurit nga robëria e mirëqenies, kurse të varfëritë nga barra e varfërisë. Duke ndjekur rrugën e Jezusit, Charles de Foucauld, dëshiron të jetë shenjë e pasurisë së zemrës – dashurisë në Hyjin, për të mirën e gjithë njerëzve, në veçanti të varfërve. Papa Benedikti i XVI e shpalli të lumtur me 13 nëntor 2005.

Lukë Shestani
Shkodër

RADIO VATIKANIT U BË ZËRI I NJË SHPRESE TË RE!

"Laudetur Iesus Christus! Ju flet Radio Vatikani në gjuhën shqipe!".
Pak kujtesë rreth Kontributit të selisë Shenjte (Vatikanit), për popullin shqiptar në periudhën 1951-1990.

Selia e Shenjtë duke njohur mirë nevojat shpirtërore për popullin shqiptar nëpërmjet themelimit të radio Vatikanit seksionit shqip në vitin 1951 të themeluar e të drejtuar nga meshtari shkodran Dom Zef Shestani nga viti 1951-1990, filloi ti përcillte popullit të vet mesazhe për (fe dhe atdhe).

Gjatë periudhës së zezë të regjimit komunist në Shqipëri, unë si përjetues direkt i asaj kohe, kam ndjekur me një dhimbje të madhe shpirtërore shkatërrimin e kishave, xhamive e të gjitha objekteve të kultit, kam përjetuar persekucionin çnjerëzor dhe eliminimin në mënyrë masive të priftërinjve, hoxhallarëve e civilëve, të cilët dëboheshin, masakroheshin e pushkatoheshin me gjyqe e pa gjyqe.

Kam përjetuar edhe ushqimin shpirtëror të Selisë së Shenjtë, evenimentin e madh që me 3 tetor 1951 shumë domethënës për popullin shqiptar e në veçanti për atë katolik: themelimin e Radio Vatikanit seksioni shqip, të drejtuar nga Dom Zef Shestani, përreth 40 (katër dhjetë) vite. Kjo ishte një dhunti e çmuar për popullin që e priti me gëzimi sidomos katolikët brenda e jashtë vendit.

Seksioni shqip i Radio Vatikanit u bë zëri i një shprese të re për të gjithë popullin shqiptar. Kudo në programet e radios, Dom Zefi përcillte celebrimet liturgjike fetare të transmetuar nëpërmjet këtyre valëve. Zërin i Atit të Shenjtë shërbej si një ushqim shpirtëror, që i mungonte besimtarëve që jetonin në ferrin komunist.Pra mbulonte sado pak nevojat për të ruajtur besimin në Zot. Seksioni në shqip i Radio Vatikanit, u bë denoncuesi para botës, pasi regjimi anti Zot masakronte e persekutonte vazhdimisht klerin.

Seksioni në shqip i Radio Vatikanit me gjithë persekucionin e madh që ushtrohej në popull, ky program pati dëgjueshmëri të madhe por në mënyrë krejt klandestine. Në orën 18.30 çdo ditë në mënyrë shumë të fshehtë njerëzit grumbulloheshin pranë radios duke dëgjuar emision që fillonte me siglën e saj tashmë të përhershme "Cristus vincit", dhe "Laudetur Iesus Christus! Ju flet Radio Vatikani në gjuhën shqipe!". Kjo radio e Vatikanit u bë një dritare e hapur plot shpresë përtej Adriatikut.

Ky zë, kjo vlerë e çmueshme feje që për popullin shqiptar në një farë mënyre zëvendësonte institucionet fetare të shkatërruara, në harkun kohor 1951-1990, solli mesazhet e pesë Papëve. Këto programe shpesh shoqëroheshin edhe me leximin e veprave të autorëve shqiptar shumë të rëndësishëm, ku pjesa më e madhe ishin pjesë e klerit katolik, mjafton të përmendim Fishtën, Mjedën, Prendushin, Harapin, Zadejen e shumë të tjerë. Veprat e tyre ishin të ndaluara nga

sistemi Komunist. Të gjitha këto materiale e të tjera punime të kontributit të çmueshme të radio Vatikanit, seksioni shqip, të drejtuar nga Mons. Zef Shestani, gjenden në arkivat e këtij seksioni, Kjo veprimtari e pasur dhe e gjatë kohore, do të ishte mirë të përmblidhen në një botim (libër), ku të dalin në dritë roli e kontributi i madh i Selisë së Shenjtë si dhe figura e Dom Zef Shestanit e cila ka mbetur e harruar, që punoi aq shumë me dashuri e përkushtim deri në vdekje për binomin Fe e Atdhe.

Dom Zef Shestani lindi në Shkodër më 29 qershor 1912, njëherësh me Shqipërinë e Pavarur. U shkollua në Kolegjin Saverian të qytetit, ku Zoti e thirri për jetën meshtarake. Të parët menduan ta çojnë për të vijuar studimet e larta, në Padovë. Ishte viti 1935.

Sapo u kthye, Dom Zefi u emërua zëvendës-famullitar i Shkodrës me seli në kishën e Shën Kollit, në Rus, ku tha Meshën e parë më 1 janar 1936. Filluan për të 3 vjet veprimtarie të pareshtur. U mor me të rinjtë, me muzikën, me publicistiken. Nisi t'i hapte baritores së Kishës horizonte të reja, gjithnjë me frymën tradicionale: Për "Fé e Atdhé". Pasi iu kundërvu pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, më 1939, e komunizmit të pafé e të paatdhé, më 1944, u detyrua të kalonte në Itali, ku rifilloi menjëherë edhe më me zell punën meshtarake e intelektuale në shërbim të idealeve, të cilave u kishte kushtuar jetën. Në sa shërbente si famullitar në dioqezën Porto-Santa Rufina, në periferi të Romës, Selia e Shenjtë në vitin 1951 e ngarkoi me detyrën të themelonte Programin Shqip të Radio-Vatikanit.

Dom Nikë UKGJINI
Shkodër

KISHA E HOTIT - PËR ZOT, ATME E PËRPARIM
(Fund)

Hoti në vitet në vazhdim

Gjatë viteve kur përcaktohej fati i shqiptareve, si në lidhjen e prizrenit 1878, kryengritjet e malësisë së madhe, 1910-1912, konferencën e londrës 1913, luftërat ballkanike etj.,në kapacitetin që kishte, hoti shfaqej si protagonist i vyer në ruajtjen e identitetit kombëtarë e fetar në trevat e malësisë dhe më gjerë. Frymëzimin për këtë kauzë e merrnin nga prijësit e tyre shpirtërorë, të cilët vazhdimisht e bashkëndanin dhimbjen dhe krenarinë me grigjën e tyre. Ky bashkëpunim qe shumë i theksuar me rastin e shpërnguljes së malësorëve në podgoricë, në kohën kur shefqet turgut pasha, me sulmet e kryera në vitin 1910, poçi e dogji malësinë.

Angazhimi i klerikeve u vërejt me rastin e ngritjes së flamurit kombëtar më 6 prill 1911, në bratil të deçiqit si dhe në formulimin e 12 kërkesave të shenjurara në "librin e kuq", të parashtruara para perandorise osmane më 10-23 qershor 1911, në kuvendin e gerçës.

Klerikët e shtuan angazhimin e tyre me popull gjatë betejave të ashpra të zhvilluara në malësi e rrethe, duke iu kundërvënë perandorisë osmane për çlirimin e vendit deri kur ajo u largua nga trevat shqiptare njëherë e përgjithmonë me rastin e shpalljes së pavarësisë në vlorë më 28 nëntor të vitit 1912.

Pas çlirimit të vendit, ëterit shpirtërorë qenë shumë vigjilentë ndaj malit të zi, kur nëpërmjet hotit, si lidhje territoriale apo fetare, tentonin që ta pushtonin veriun e shqipërisë. Me këtë rast poeti fishta do hartonte vargjet e himnit kombëtar, "porsi fleta ejllit zotit, po rreh flamuri I shqipënis..." në shenjë uniteti të shqiptarëve të të dyja besimeve, qe lidhur banderola kuq e zi nga minarja e xhamisë fushë qelë, me kompanjelin e kishës françeskane në fillim të vitit 1913.

Konferenca e ambasadorëve të londrës, e vitit 1913, e ndikuar nga shtetet sllave ortodokse, përfundimisht vulosi në mënyrë arbitrare copëtimin e trojeve shqiptare nga trungu i atdheut, ku pothuajse gjysma e popullsisë mbetën jashtë kufijve shtetërorë, në veri të shqipërisë. Rezultat i këtij vendimi famullitë katolike si, traboini, me 9 fshatra dhe 1.276 shpirtra; gruda,

me 15 fshatra dhe 2.242 shpirtra; vuksan lekaj, me 5 fshatra dhe 397 shpirtra, dhe kllezna me 235 shpirtra, do bëheshin pjesë e mali të zi, përkatësisht jugosllavisë, në vitin 1919. Edhe pse politikisht i takonin malit të zi, falë klerikëve atdhetarë dhe popullatës, e cila në shpirtin e vet të plagosur do të mbante një vetëdije të lartë kombëtare, në aspektin kishtar, deri në vitin 1923, këto famulli kishin ngelur pjesë e kryeipeshkvisë së shkodrës.

Për shkak të rrethanave politike dhe dëshirës për t'u siguruar famullive kujdes shpirtëror më të lehtë dhe më të mirë, Selia e Shenjtë vendosi me dt. 8 mars 1923, t'ia jepte këto famulli nën administrimin e përkohshëm, Kryeipeshkvisë së Tivarit. Në lidhje me këtë vendim të "Kongregatës për Ungjillëzimin e Popujve" (Kongregatio de Propaganda Fide) në Romë, Kryeipeshkvi i Shkodrës, Imzot Lazër Mjeda, (1922-1935), në letrën e tij nr. 223/ dt. 24 mars 1923, njofton kryeipeshkvin e Tivarit, Imzot Nikolla Dobriçiq (1912-1955).

Meqenëse situata politike me dominimin e komunizmit ateist në Evropën Juglindore, kishte rënduar për të keq, në vitin 1976, famullitë e lartpërmendura u bënë përfundimisht pjesë e përhershme e Kryedioqezës së Tivarit.

Barinjtë shpirtërorë vyer të Hotit

Famullia e Traboinit

Për t'u njohur më mirë me historikun e barinjve shpirtërorë dhe ngjarjeve kishtare, kemi shënime të vyera nga "Misionet Shëtitëse" (Missione Volante) të jezuitëve, të cilët gjatë vitit 1889 dhe 1903 kanë qëndruar kohë pas kohe në këto zona.

Përmendim këtu shënime rreth famullisë së Trabonit dhe Rapshës, të Atë Domenico Pasit, të botuar nga Atë Fulvio Cordignano, Romë, 1934-42. (Libri është botuar në gjuhën shqipe me titull "Shqipëria", nga shtëpia botuese "Almera", Tiranë 2008).

Në shkrimet e tija, Domenico Pasi thekson së barinjtë shpirtërore ishin ata, të cilët promovuan edukimin fetar dhe kultivuan atdhetarizmin në përballje me pushtuesin osman.

Sipas Pasit, i cili jep shënime për gjithë Malësinë, në vitin 1864, Rapsha kishte 1253 besimtarë dhe Traboini, 1187 besimtarë. Të dyja famullitë administroheshin nga Etërit Françeskanë, me qendër të tyre në Kastrat.

Në vitin 1889 D. Pasi flet për famullitarin Atë Nikolla nga Trento, si famullitar i Traboinit (Arzes), i cili edhe në valën e torturave osmane më 17 tetor të vitit 1889, kishte arritur të organizonte përgatitjen e sakramentit të krezmimit për 50 fëmijë. Për ndarjen e këtij sakramenti kishtar, kishte arritur ta siguronte Izmot Paschuale Guerrinin, Kryeipeshkëv i Shkodrës. Kurse në vitin 1897, kur famullitar ishte Atë Basilie nga Dongo, gjatë misioneve shëtitëse, në një Kishë të vogël e të dërrmuar, ishin pajtuar disa gjaqe brenda famullisë si dhe gjaqe që kishin ndodhur në familjet e famullive të tjera.

Në vitet e mëvonshme, gjejmë në krye të famullisë së Traboinit, Atë Luigj Bushatin dhe në Vuksanlekaj, Atë Karl Prennushin, të cilët heroikisht përballuan torturat e dhunën e ushtruar në popull nga Turgut Pasha, kur në vitin 1911, poçi e dogji Malësinë.

Atë Marjan Prela, etnograf, folklorist i njohur, spikat në këtë famulli, kur serbët e kishin djegur Kishën dhe arkivin e pasur të famullisë. Ai ndërtoi shtëpinë e Zotit - Kishën dhe shtëpinë (qelën) e banimit, duke vepruar me plot përshpirtëri gjatë viteve 1923-1931.

Në vitet në vazhdim, për shkak të mungesës se etërve françeskanë, në këtë famulli vepruan për

një kohë të shkurtër priftërinj dioqezanë: Don Ivo Bushiq, (1931-1935) e Don Jure Filipoviq, (1935-1937). Më pas u rikthyen etërit françeskanë dhe detyrën e famullitarit e mori martiri i fesë dhe i kombit, Atë Leonard (Zef)Tagaj, mirditor i lindur në Ljarë të Shestanit. Gjatë qëndrimit të tij në Traboin, në vitet 1937 -1945, si aktivist i shquar për fe e atdhe dhe si mjek popullor, kishte rënë në sy të qeverisë komuniste malazeze, që, për ta hequr qafe bariun e mirë të grigjës së Zotit, e pushkaton më 19 shkurt 1945, jo larg famullisë se Traboinit. Bariu i grigjës, i cili për një kohë shumë të gjatë veproi në këtë famulli (1945- 1972), duke i dhënë një kontribut të çmuar kulturës shqiptare ishte Atë Kolë (Eugjid) Gilaj, Berishaj nga Gruda. Ai i kreu me një përshpirtëri të madhe shërbimet fetare e kombëtare në këtë famulli, duke u përballuar vazhdimit me presione fizike e psikologjike nga sistemi komunist malazez e serb. Sipas dorëshkrimeve të tija, në vitin 1945, në shtëpinë e famullisë, për 10 vite me radhë, kishte lëshuar një dhomë për shkollë shqipe.

Për të krijuar kushte më të përshtatshme për besimtarët dhe famullitarin, në vitin 1950, Atë Kola kishte restauruar Kishën e Traboinit, kishte ndërtuar kompanjelin si dhe kishte restauruar shtëpinë e famullisë.

Ai ishte studiues i vyer i dokeve dhe zakoneve shqiptare në veri të Shqipërisë. Brumin studimor e kishte vjelë ndër burrat e Hotit. La në dorëshkrim kujtime të vyera për këtë periudhë kohore. Sipas Don Nosh Gjolaj, pas atë Kolës, famullia e Traboinit është administruar nga Misioni Françeskan i Tuzit, nga Atë Nokë (Ndue) Senishtaj, 1974-1975; famullitari, Atë Vito Smoljan, 1976-1980, i cili ishte marrë me zgjerimin e Kishës dhe shtëpisë; Atë Anselm (Gjergj) Marstepaj, 1980-1988, i cili e administroi Traboinin nga qendra e Misionit të tyre në Tuz. Së fundi, nga viti 1989 famullitar është Atë Frano Dushaj me qendër në Sukruq.

Famullia e Rrapshës

Edhe pjesa tjetër e Hotit, Rrapsha (Brigja e Hotit) pati një seri famullitarësh, të cilët luajtën një rol të rëndësishëm në këtë famulli, duke e trajtuar gjithnjë si pjesë të një tërësie të këtij fisi.

Gjatë vizitës në Rrapshë, së bashku me ekipin e tij paqëtues, Atë Domenico Pasi, nuk ka lënë ndonjë shënim të veçantë. Ai flet vetëm për

pajtimin e disa gjaqeve dhe mungesën e famullitarit të rregullt, që duhej të administrohej nga famullia e Bajzës apo Kastratit.

Në pragun e largimit të Perandorisë osmane nga trojet shqiptare, në vitet 1911-1912, veçohet angazhimi vetëflijues i famullitarit Atë Sebastian Hila, i cili, së bashku me besimtarët, mbrojtën pragun e shtëpisë nga sulmet gjakatare të Turgut Pashës. Po kështu u veprua edhe në vitin 1913, kur serbët e malazezët sulmuan veriun e Shqipërisë, duke tentuar që të zgjeronin edhe më tepër kufijtë e Malit të Zi.

Në kohën e qetë të mbretit Zog, në vitin 1927, shënohet se kjo famulli kishte Kishën e vet në Brigje të Hotit, me 750 besimtarë. Ndërsa në vitin 1938, gjejmë famullitar, Atë Pal Çurçinë.

Me ardhjen dhe instalimin e sistemit komunist në Shqipëri, 1944-1945, Kisha Katolike përjetoi përndjekje dhe persekutime të papara në botë. Në vorbullën e këtyre torturave, kleri katolik tani duhej ta mbronte jetën e vet jo më nga huajt, por nga të vetët.

Gjatë kësaj kohe, me Kishën në Brigje, shënohej një numër i vogël i atyre që shërbyen në famullinë e Rrapshës. Në vitin 1943-1946, kemi Atë Gaspër Sumën, meshtar i thjeshtë dhe i përshpirtshëm, i shkolluar në Insbruk, martir i Kishës, i cili për shkak të kundërshtimit të sistemit komunist, qe pushkatuar në vitin 1947. Më pas, përgjatë viteve 1952-1962, në krye të kësaj famullie erdhi gjuhëtari, etnografi dhe etnologu i njohur shqiptar, Atë Benedikt Dema, i cili gjatë qëndrimit në Rrapshë, hartoi vepra të vyera letrare e gjuhësore të cilat i la në dorëshkrim. Deri në mbylljen përfundimtare të kishave në Shqipëri në vitin 1967, kjo famulli administrohej nga Bajza dhe famullia e Kastratit.

Në kohën e ardhjes se lirisë fetare në Shqipëri në vitin 1990- 1991, sikur filloi një epokë e re kishtare. Kleri i moshuar, i cili kishte mbijetuar, filloi të ringjallej, duke u angazhuar nëpër Kisha, në ungjillëzimin e popullit me ato mundësitë fizike që kishin. Në ndihmë të Kishës në Shqipëri erdhën klerikë nga Kosova, Mali i Zi si dhe misionarë nga vende të ndryshme edhe jashtë kontinentit Evropian, të cilët i dhanë një shtytje të madhe kësaj Kishe të rrënuar nga sistemi komunist e ateist.

Pas demokratizimit të Shqipërisë, në famullinë e Rrapshës kemi françeskanin nga misioni i Tuzit, Atë Prelë Gjurashaj, i cili së bashku me hotjanët, filloi ndërtimin e Kishës së re, jo më në Brigje, ku ishte më parë, për shkak të mungesës se hapësirës, por në Kushe të Hotit. Puna në ndërtimin e Kishës, filluar në vitin 1992, kulmoi me inaugurimin madhështor me 21.08, 1994, financuar nga emigracioni në Amerikë. Me këtë rast shënohet pjesëmarrja e prelatëve të lartë kishtarë, si dhe e përfaqësueseve nga Amerika, Marash Kolë Pllumi me të vëllain, Gjok Deçka, Gjeto Frano Junçaj, Nikollë Ndou Junçaj, Nikollë Preka Junçaj Frano Shkreli etj.. Atë Prela qëndroi në Hot nga vitit 1993-1998, si bari shpirtëror për t'u rikthyer përsëri për të ungjillëzuar, në vitet 2000-2005. Me intervale, Rrapsha është administruar edhe nga Atë Marjan Lumçi, 1998-2000 dhe Dom Nikë Ukgjini, 2005. Famullitar i rregullt ishte Dom Charbel Bachour, dhjetor 2005-2013, dhe tani Dom Ardian Arra.

Përfundim

Padyshim, historia e kësaj famullie është e lidhur ngushtë më historinë e Kishës shqiptare në përgjithësi, e cila punoi në mbrojtje të se vërtetës hyjnore të shpallur sipas mësimit të fesë së krishterë, që në këtë botë është rendi, drejtësia e barazia, paqja e dashuria dhe mirëqenja. Kjo bëri që malësorët, së bashku me klerin, të vazhdonin ta bënin luftën deri në veteflijim, jo me shpresën se do ta fitonin atë, kundrejt një Perandorie, por me qëllim që ta tërhiqnin vëmendjen e Fuqive Ndërkombëtare katolike mbi çështjen e kombit dhe të fesë të shqiptarëve në veri të Shqipërisë. Këtij qëllimi hotjanët ia arritën së bashku me Malësorët e tjerë, duke bërë që në këto troje të valvitet flamuri kombëtar dhe në pjesën tjetër në Traboin, të ruhet gjuha, tradita burrëria dhe krenaria e shqiptarit.

Edhe në vitet në vazhdim, kohës së mbretit Zog dhe sistemit degradues komunist, Hoti në të dy anët, ruajti ndjenjat e një bashkësie unike kombëtare e fetare, duke e ndihmuar dhe respektuar njeri-tjetrin në të dy anët e kufirit dhe me mërgimtarët në SHBA.

E gjithë kjo është një tregues se fisnikëria e trashëguar në shekuj, ka arritur të kultivohej e të thundrojë në shpirtin dhe zemrën e këtij fisi deri në ditët e sotme.

Mund të themi se gjithë jeta e tyre, si bashkësi unike fetare, arriti të funksionte sipas trinomit Për Zot, Atme e Përparim. Me të drejtë, poeti kombëtar Atë Vinçenc Prennushi, në poemën e tij do këndonte "Të Falëm o Krygje..... Për Atdhe e Fe na dona vehten gjithmonë me e shkri".

Ndue DEDAJ
Rrëshen

MESHA E PARË E ERËS SË RE

Nuk është fjala për meshët e para të Erës së Re, dy mijë vjet më parë, por për "erën e re" shqiptare që nis me rikthimin e institucioneve fetare në Shqipëri, në vigjilje të mijëvjeçarit të tretë, kur duheshin dhe dhjetë vjet të fillonte shekulli XXI. Nuk mund të merrej ndryshe, veçse si një "ngjarje në tokë", siç do të thoshin prelatët e martirizuar, ndaj kisha katolike i kishte nisur prej kohësh përgatitjet për përkujtimin e meshës së parë, të mbajtur me 4 nëntor të vitit 1990 në Shkodër, nga kleriku i njohur dom Simon Jubani, një meshë që shënoi edhe fillimin e lirive fetare dhe proceseve demokratike në vend. Ngjarja e lumnueshme ndodhi njëzet e pesë vjet më parë, në Varret e Rrmajit, restauruar kohët e fundit. Ishte si një apostullim i ri në tokën e mbetur djerr nga besimi, dhe pse në këto troje iliriane pati predikuar vetë Shën Pali Apostull.

Ishte Dom Simoni i pari, por do të ishte patjetër një meshtar që do ta riniste meshën e dhunuar e ndaluar. Mund të kishte qenë Dom Shtjefën Kurti, famullitari i mirënjohur i Tiranës, që ishte arrestur e ekzekutuar në fillim të viteve '70 vetëm pse kishte pagëzuar një fëmijë. Shqiptarët, pos të rinjve, e mbajnë mend se si ishte ngritur në këmbë i madh e i vogël kundër "zakoneve prapanike" e "mbeturinave fetare", por dhe "shfaqjeve të huaja borgjezo-revizioniste", ku do të kishte shumë të salvuar nga radhet e artit e kulturës, por dhe të klerit që kishte mundur të mbijetonte deri atëherë. Mjafton që lexuesi i ri ta verë pak mendjen në punë se cilat ishin ato që quheshin zakone prapanike, as më pak e as më shumë se traditat më të vyera të të parëve tanë: doket, paria, prija, kulla, kuvendet, ritualet, festat, veshjet, besa, e cila tash e mbrapa i duhej dhënë vetëm Partisë. Kurse "mbeturinat fetare" ishin: besimi në Zotin, që për njeriun ishte shpirtëror

dhe i shenjtë e tash duhej zëvendësuar më parullat leniniste ("Feja është opium për popullin"), famullia, teqja, xhamia, bajrami, pashkët, shkollat e vjetra, arkivat kishtare, ku ishin të dhënat familjare, krahinore dhe kombëtare. Mund të kishte qenë çuesi i meshës së parë cilido meshtar tjetër i martirizuar nga regjimi komunist, klerikët e përfshirë në procesin e kanonizimit nga Selia e Shenjtë, nëse do të ishin gjallë, portretet e të cilave u varën në qiellin e Tiranës për herë të parë shtatorin e kaluar në pritje të Papa Françeskut.

Por a ua kemi bërë sa duhet nderimin? Ende jo. Historia e Shqipërisë moderne është mungestare pa polifoton e tyre, ashtu si ajo gjendet në veprën "Rrno vetëm për me tregue" të At Zef Pllumit, që është dhe bestselleri i shkrimtarisë së kujtimeve në këto njëzet e pesë vjet. Ndërgjegja jonë do të ishte e mangët pa këtë dëshmi madhore, ajo do të lëngonte. Por nuk është gjithçka një libër, një dokumentar, një dekoratë e lartë, një përmendore e këtij apo atij të salvuari të fesë. As dhjetëra të tilla, qoftë dhe të arrira. Problemi nuk është thjeshtë i natyrës përkujtimore, jo se kjo nuk do bërë me përkushtim të madh, por kërkohet diçka më sipërane: të endet filli moral i këputur i gjysmëshekullit ateist, për të ndërlidhur ndërgjegjën fetare-kulturore të shqiptarëve në shekuj. E kjo nuk mund të bëhet pa i shkoqitur aktet, ngjarjet, dëshmitë e martirizimit. Janë ca gjera të shënuara që nuk mund të anashkakohen as pa dashje.

Emision për katoliçizmin, pa kardinal Koliqin!...

Në gjithë historinë e katoliçizmit dymijëvjeçar kemi vetëm një kardinal shqiptar, Imzot Mikel Koliqin, që është pritur dhe nga Gjon Pali II në Vatikan, ani pse për shkak të moshës së thyer dhe sëmundjeve nuk mund të vente rregullisht në takimet me kardinalët, aty ku ai kishte "karrigen" e tij. E megjithatë ky prelat i lartë qëllon që harrohet. Me rastin e vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri, shtatorin e kaluar, në njërin nga televizionet kombëtare, u dha një emision kushtuar katoliçizmit. Një emision televiziv sigurisht që nuk është një akademi shkencore, ku gjërat shihen me referenca para se të kumtohen, por nuk është dhe një tryezë spontane ku mund të thuash shumë gjera, duke harruar disa me domethënie të veçantë. Në atë emision kardinali i parë shqiptar, Koliqi, duhej të ishte i "pari". Po kështu në asnjë rast, kur bëhet fjalë për ringjalljen e kishës, nuk mund të lihen mënjanë dhe tre nga ipeshkvijtë e parë që u shuguran nga Papa Gjon Pali II në Katedralën e Shkodrës në prill të vitit 1993, Imzot Frano Illia, Imzot Zef Simoni dhe Imzot Robert Ashta, që tash janë në amshim.

Flitet për martirët e kishës dhe nuk thuhet se një martir i kombit është dhe At Shtjefën Gjeçovi, siç nuk përmendet as At Luigj Paliqi i vrarë në Kosovë me 1911. Kur është fjala për persekutimin e klerit duhen thënë të gjitha ngjarjet e papërsëritshme, pra dhe fakti që prifti deputet Dom Gjon Gazulli u var në litar në Fushën e Druve në Shkodër në vitin 1927, ku ka dhe një foto të këtij ekzekutimi publik, online, do të thuhej sot. Mbreti Zog nuk ia kurseu jetën kritikuesit ekselent të regjimit të tij. E vërteta nuk mban me hatër askënd, dhe nëse një akt të tillë e harron një panel televiziv a një tjetër. Ashtu siç duhej thënë se dhe vëllai i këtij meshtari, Dom Nikollë Gazulli, gjuhëtar i formuar, ekzekutohet në rrethana të dyshmta politike në vitin 1946. Ky është problemi, ai i vërtetësisë dhe plotërisë së thënies. Ja që nuk bëhet fjalë për harresa të vogla dhe jo vetëm mediatike.

Shumë nga vuejtësit e dënimeve të rënda e të gjata politike nuk arritën t'i shkruanin kujtimet e tyre, pasi Dom Nikollë Mazreku, që kishte shkruar aq shumë për historinë e shqiptarëve, nuk kishte më fuqi të shkruante kujtimet vetjake ato pak vite që rroi në liri. Bashkëvuajtësi i tij, Nikollë Zef Tuci, ia kishte nxjerrë dorëshkrimet nga burgu aty nga viti 1974, fshehur në një bidon vaji, dhe ato kishin ndenjur shtëpinë e tij në Orosh deri në 91-in, kur ia kishte dorëzuar të zotit në Shkodër. Këso historish janë të pashembullta edhe në qasjen e disidencës shqiptare, që shpesh padrejtësisht themi se nuk ekzistonte. Çfarë tjetër, përveçse disident i dorës së parë, mund të ishte At Pjetër Meshkalla, një profesor e dijetar klasi, që u përballë me udhëheqjen më të lartë politike të Tiranës për fenë, filozofinë, shkollën, progresin shoqëror e kulturor.

Kardinal Koliqi ishte një legjendë e gjallë e kishës dhe kulturës, famullitar i Shkodrës, muzikant i qytetit të vet, botues i revistës "Kumbona e së Diellës", një "Mandelë" i burgjeve famkeqe shqiptare. Mesha e parë është një rast për t'i kthyer sytë nga ai dhe klerikët e tjerë qendrestarë, në të gjitha ditët. Më shumë se për kujtesën ndaj tyre, që ua kemi peng nderimi, puna është ta endim vërtetë atë fillin e këputur prej ateizmit "shkencor", që arriti të kishte muzeun e parë dhe të vetëm ateist në botë, në Shkodër, njëlloj si t'i bëhej Romës një "dhuratë" e tillë absurde e paimagjinueshme. Për të mos mbetur teorik në këtë që po themi, revista "Hylli i Dritës" është njëra nga kolanat që është përpjekur denjësisht këto vite ta ndërlidhë aksin kulturor shqiptar të ndërprerë, traditën kulturore kishtare me "erën e re" të saj.

Na duhet ende vullnet dhe punë e fisme intelektuale e institucionale për t'i dhënë kujtesës historike dinjitetin e nëpërkëmbur. Dom Gjergj Meta shkruan: "Papa Françeskut, në korrik të këtij viti, Presidenti bolivian Morales, i dhuroi një Krisht të kryqëzuar, në një "drapër e çekan", që janë shenjat e ideologjisë komuniste. Një simbolikë e gjetur dhe prekse.

Në atë mënyrë komunizmi kishte gozhduar të krishterët. Nën atë simbol u shfarosën, burgosën e përndoqën shumë sosh. Ne shqiptarët e dimë mirë këtë gjë, më shumë se kushdo tjetër. Krishti u kryqëzua me ato vegla, që nga mjete pune u kthyen në instrumente dhune dhe vdekjeje. Por edhe nga ky varr të krishterët u ngritën…"

Mesha e parë në Shkodër në nëntor të 90-s ishte rrezja e lirisë së ringritur nga hiri i martirizimit apostolik e bashkëkohor.

Violeta MURATI
Tiranë

NË KISHËN E MJEDËS, NË KUKËL

Me rastin e datëlindjes se poetit Mjeda
(Takim letrar 21. Nëntor 2015) .

Për të gjetur shtëpinë dhe Kishën e Mjedës, në rrugën drejt Kuklit mungon orientimi, asnjë guitë drejt qendrës unike në Shqipëri.

Një ditë gri, me mjegull, por jo e zymtë për Kishën e Mjedës në Kukël. Në fundjavën e shkuar, aty ku shtëpia e poetit është kthyer në muze dhe në kishën ku shërbeu në jetën e tij të dytë, prej pesë vitesh Dom Nik Ukgjini mban "meshë" letrare në faltoren e Zotit.

Është gjë e rrallë për jezuitët që t'ua lirojnë "vendin e shenjtë" poetëve e muzikës. Nga Kosova e Mali i Zi, në kishën e Kuklit mbahet fryma, për të përshpirtur vargje e vizione që herë duken të prekshme e të njohura, e herë të largëta dhe plot mistere.

Ja, rasti për Mjedën është krejt unik. Piktori i famshëm i Kosovës, Rexhep Ferri sapo mbërrin shtrëngon duart me miq e të panjohur, e menjëherë shpjegon arsyen e fortë patriotike pse ndodhet aty: Im atë ka udhëhequr kryengritjen e Koplikut, e ndaj dua të vij këtu përherë, edhe pse s'më lidh asgjë tjetër me Shkodrën.

Në krye të shkallëve, ku është vendosur shtatorja gjigante e Mjedës me veladonin-këmborë të priftit, Dom Nik Ukgjini pret miqtë e besimtarët nga Shqipëria, Kosova e Mali i Zi, duke kuptuar ndjeshmërinë: dua t'i bëj bashkë, të gjithë! Janë studiues letrarë, poetë, nxënës shkolle, besimtarë, gazetarë që mblidhen e ftohen për vit në kishën e Mjedës.

"Vijnë këtu ata që e duan dhe e kanë në zemër Mjedën", – thotë aktorja shkodrane, Merita Smaja, në fjalën e saj në jubileun e pestë të takimeve.

Vendosur rrëzë një kodrine të butë, dy godinat të lidhura bashkë, kisha dhe shtëpia-muze e Mjedës ngjajnë të lartësuara, të madhërishme, me hije të rëndë pas supeve të poetit. Të gjithë ftohen së pari të hyjnë në shtëpinë e poetit, e kthyer në qendër muzeore.

Piktori Arben Golemi ka sjellë për këtë rast disa vizatime në një ekspozitë dedikimi në emër të galerisë së arteve. Drejtorin e saj, "heroi" që ka ngritur në këmbë shtëpinë e poetit dhe e ka shndërruar në një nga qendrat më të vizituara, Dom Nik Ukgjinin nuk e zë aq lehtë entuziazmi i misionit të përmbushur. Atë e shqetëson fakti se Shkodra, krahasuar me qytete të

tjera, ka pasur mjaft figura, që për fat të keq, pak prej tyre kanë mundur të ruajnë relikte, apo të kthejnë shtëpitë në muze si nderim e kujtim apo udhërrëfyes për brezat.

Kështu, jo fort larg Shkodrës, në fshatin Kukël- që i përket komunës së Bushatit, ka jetuar për 30 vite më radhë ky rilindas i madh, poeti më shquar i lirikës shqiptare Ndre Mjeda. Kompleksi i tij, (Kisha, shtëpia) gjatë kohës së komunizmit për fat të mirë ka mbijetuar. Dhe gjatë viteve 2011- 2012, është risistemuar ambienti, është restauruar Kisha dhe shtëpia e ndërtuar nga vetë dora e poetit. "E gjithë puna e madhe ka përfunduar më 18 tetor 2014, kur dhe u bë hapja solemne e shtëpisë-muze. Në këtë vit (2015) është realizuar filmi dokumentar kushtuar Ndre Mjedës dhe Qendrës Muzeore me titull 'Ndërtuesi i fjalës dhe i veprës', si dhe një guide prej 70 faqesh në gjuhen shqipe dhe në anglisht", – na saktëson Dom Nikë Ukgjini, duke na thënë se këtu ka një dyndje të vizitorëve nga trevat shqiptare, të cilët vijnë me dëshirën për t'u gjunjëzuar para poetit, përkthyesit, politikanit, intelektualit të spikatur, Ndre Mjeda.

Por për të shkuar deri në shtëpinë e Mjedës s'ka asnjë tabelë, asnjë sinjalistikë të ngjashme rrugore apo guidë prezantuese për turistët. Ky është edhe shqetësimi i priftit, por dhe i atyre që mbërrinin njëri pas tjetrit me aventurën e ngatërresës së gjatë të rrugës për në kishën e Mjedës.

Para se të hyjmë në gjendjen hyjnore e pështjellimeve lirike të Mjedës, Dom Nik Ukgjini, që kërkon ta kthejë vëmendjen te një situatë më tej se kisha, thotë se më shqetësuese për momentin është dhe gjendja e përcjellësve elektrikë në fshatin Kukël, ku shtyllat janë të dëmtuara dhe ndodhen nëpër pemë dhe buzë rruge, telat e kryqëzuar nëpër rrugë dhe të copëtuara. Dom Nikë Ukgjini tregon se për këtë arsye u pezullua dhe udhëtimi i vajzave të "Miss Globe" që do të njiheshin me qendrën kulturore. "Rreth këtij problemi, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, më shkresën, prot. 5236, dt. 17.11. 2014, iu drejtua Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, dhe kjo e fundit e pati vënë në lëvizje OSHEE-në në Shkodër, por situata deri tani sikur ka mbetur 'status quo", – shpjegon prifti. Me vetëdijen se tanimë qendra po merr përmasa ndërkombëtare, Dom Nik Ukgjini pasi flet për sakrificat, thotë se kanë kërkuar lëmoshë deri në Amerikën e largët, duke kërkuar mirëkuptimin e institucioneve për zgjidhjen e problemit, me të cilat po përplaset kjo qendër unike në Shqipëri.

Kështu janë habitur dhe të ftuarit, poetët të cilët nuk kishin prekur ndonjëherë fjalën në foltoren e kishës. Studiuesi Behar Gjoka do ndante mu aty "andrrën" e parealizuar, se si një dorëshkrim studimor mbi veprën e Mjedës i ka humbur, po mundi të ndante me miqtë se "Andrra e Jetës" është një kryevepër e padiskutueshme, një kryevepër klasike në letërsinë tonë. Përvoja e mjeshtrit, filozofit dhe atit shpirtëror- një triniti për Gjokën si vlerë shqiptare.

Çaste muzike e kompozuar nga At Martin Gjoka, "Përmbi lumë Babiloni" e të tjera, luhen në foltore. Edhe Shendi i vogël mban gjithë kohën një vëllim me poezi për fëmijë dhe me një zë kumbues, me plot dashuri do recitonte vargje të Mjedës.

Ndërsa ndalet në asketizmin e Mjedës, si model i lirikës shqiptare, e aristokrat i gegnishtes, shkrimtari Agron Tufa tregon se është një rast unik në letrat shqipe përkthimi i vëllimit të dytë nga Fausti i Getës. Bëhet fjalë për "Mbreti i Tules", përkthyer së pari nga Mjeda, dhe pas tij njihen 17 përkthyes. Por asnjë prej tyre, tha Tufa, nuk kanë arritur të krijojnë një ritëm, figuracion e sidomos kadencë aq të rrjedhshëm të shqipes. Por kjo histori vazhdoi më gjatë mes poetëve e studiuesve Sadik Bejkos, Behar Gjokës, Demir Gjergjit e Pandeli Koçit, duke kujtuar përmendësh gjithë vargjet e "Mbretit të Tulës", si një histori unike që kurrë deri tani nuk ishte përmendur. Besnikëria deri në vdekje e Mbretit të Tules, i fundit, e fundit jetë, e fundit dashuri, e fundit mbretëri…

I larguar nga Shqipëria më 1880, Mjeda studioi në qendrat më elitare evropiane: Milano, Paris, Spanjë, Poloni, Dalmaci dhe pas shumë kohe kur u brumos me kulturë evropiane, u kthye në vendlindje në një kohë kur ajo ndodhej nën pushtimin osman.

"Shqipërinë e la nën vuajtje dhe gjeti nën vuajtje. Kjo e nxiti që t'i kushtohej për të edukuar me edukatë krishtere, portë merrej dhe me fusha të tjera ku kishte zbrazëti sa i përket letërsisë e poezisë, përkthimeve dhe shumë fusha të tjera". Por veprimtarinë e tij më të madhe, ëndrrën e tij e realizoi në Kukël, në shtëpinë e tij, në katin e dytë, në dhomën e djathtë, në atë tryezë që gjejmë sot, dhe në kishën e tij në krah, ku është lutur që Zoti të mishërohet në këtë popull…Kjo e ka nxit të punojmë pa ndërprerje, ndaj jeta e tij ka qenë e begatshme", – na thotë Dom Nikë Ukgjini…

Gazeta Mapo, 24 Nëntor 2015

Nikollë KERHANA
Zym- Prizren

OFSHAMA E ANTON PASHKUT
(1937 – 1995)
(Në 20-vjetorin e vdekjes)

Anton Pashku, gjeniu i modernitetit në letërsi shqipe- veprat e të cilit duhet lexuar e rilexuar edhe përtej tekstit dhe heshtjes karakteristike së tij. Por, edhe qeshja nën hundë e tij, kishte një domethënie të fshehtë enigmatike.. Në një rast, kur kritikët në gazeta patën përfolur për Antonin- gruaja e tij Paulina, i tha: Anton-ke kritika në gazetë. Ai iu përgjegj: S'prish punë, unë e kam kryer punën dhe obligimin tim -ata le ta kryejnë punën e vet-jam i kënaqur që merren me mua! Do të reagosh - i tha ajo? –Jo, le të reagojë i treti....Me këtë, jep për të kuptuar se kritika duhet të jetë e lirë, e hapur dhe demokratike por me bazë të arsyeshme dhe argumentuese.

Ai në rininë e herëshme vinte shpesh në Zym, ku kishte dajat -Kërhanët, nga ku siguristh, kishte marrur motivin (në vitet 1952/3) për të shkruar më vonë tregimin "Nën qarr po rrinte vasha" (1959), botuar në librin "Lutjet e mbrëmjes" e të tjera. Ai, e kishte parasyshë Lisin e Patër Dedës, lis mbi treqindvjeçar që gjendet edhe sot në trekëndëshin: kishë - lisi - shkolla. Derisa ne (unë dhe baca Ndue) qëndronim pranë furrës dhe gropës së gëlqerës (e cila ishte në vendin ku tani është ndërtuar Qendra Përkujtimore, tek Lapidari "Abetarja e Zymit") vështronim ambientin.(Aso kohe në Zym, Qereqhanja ishte në përdorim të të gjithë familjeve të fshatit për ndërtimtari dhe lyerjen e shtëpive). Ne kishim përqëndruar shikimin edhe në drejtim nga Lisi i Patër Dedës (Lis i vjetër i tabuizuar -pikë orientimi). Pranë lisit -qarr, ishin ulur dy vajza: Motra e tij -Vera (veshur me fustan dhe me flokët gërshet) dhe Marta çika e hallës së tyre - motër e babait të tij -Tonit, tani Lumezhi-e veshur në veshje fshatarake të Zymit -veshje të çiknisë. Baca Nue i vëzhgonte me interes -siguristh për të formuar idenë për të shkruar diçka në të ardhmën. Syri i tij ishte si syri i kamerës i cili depërton thellë në brendinë e objektit të cilin e trajton: e rritë, e afron, e largon duke e analizuar thellësisht. Ishte ky syri i Anton Pashkut-Qarrit të Hasit.

Shkrimet e tij duhen vlerësuar edhe përmes heshtjes dhe përtej tekstit që shkruajti. Pra, me këtë thellësi të mendimit filozofik në tekst, për t'u bërë Antoni klasik i letërsisë moderna shqipe, më i veçanti për nga kodi letrar, mendimtar i qetë e i kursyer në fjalë për t'u vlerësuar Xhojsi i letërsisë shqiptare, i shëmbëlltyrës së papërseritshme që



duhet nënshtruar çdo analize mikroskopike efekteve të strukturave të fjalëve dhe fjalive. Andaj edhe është reprodukuesi dhe ruajtësi më i mirë dhe më i suksesshëm i fjalorit dhe frazeologjizmave hasjane. Realisht, të folmën e thjeshtë e ngriti duke e bërë mbretëreshë poetike, gjuhë estetike si dhe prozë poetike. Njëkohësisht ka krijuar edhe formën e përdorimit të përsonazheve paemra, emra të përgjithshëm: Zhelani, Floçka, Anglezi, Vuri, Turri etj, si dhe emra-togfjalësh,si: Njeriu me kapelë, Njeriu me Vrragë, Njeriu me mullungë në Kokë, Njeriu që i ka shpërthyer vaji, Njeriu me dorza të zeza apo të përhimta etj.

&*&

Duhet theksuar se Pashku përdorte fjali me një fjalë të vetme, fjali dykryegjym-tyrëshe (kryejalë-kallëzues), fjali të përbëra si dhe ligjerata-periudha të gjata me më shumë se dy fjali apo një tekst të gjatë letrar pa asnjë pikë... Të gjitha këto

kuptimplota me domethënie të thella letrrare-filozifike.Psh. “Guri”, “Guri u rrokullis”, “Guri u rrokullis nga maja”, “Guri i Madh u shkëput nga shkëmbi duke u rrokullisë nga maja merrë edhe gurë të tjerë me vete derisa vet bie në humnerë, të tjerët vazhdojnë rrokullisjen duke formuar një singjirë...” , etj. Dhe, nga e gjithë kjo, ai frymëzimin dhe inspirimin e mori nga trualli dhe nga gurët dhe rrasat e Zymit. Ai më shoqëronte deri sa shkoja me bagëti. Rrugës ndizte cigare. I thoja: pse po pinë duhan?-Më thoshte: vetëm një, sa për të ndalur dhëmbjen e dhëmballës. Diresa unë vazhdoja me përcjelljen e lopëve, në Krenza, në Bokë të Madhe, nën zabel t'Kërhanëve apo përtej rrathëve, ai, në rrasa vizatonte diellin me dy tre rreshta shkrimi nën te. Vizatonte qiellin dhe retë, nën te, prap shkruante disa rreshta shkrimi. Vizatonte shtëpia të vjetra e ku di unë se çka tjetër. Unë, ende nuk dija t'i lexoja –vetëm vëzhgoja, sepse nuk fliste. Ato shkrime ia kishte falur malit sikur Pjetër Bogdani. Derisa Pjetër Bogdani krijoi fjalë të reja për të psuruar fjaloron e gjuhës shqipe, Anton Pashku të folmën e Hasit e ngriti në nivelin më të lartë artistiko-letrar, për të cilin veprim ia ka lakmi çdokush . Ai në Has, në moshën e rinisë mblodhi gurë e drurë e bëri murë, në Grazhdanik, në Prizren e në Has mblodhi gurë, tullë e katullë e ndërtoi Kullë-a.



Nga ai, diçka e veçantë:

Baca Ndue, Anton Pashku, kishte idenë e shkollimit të mëtejm si dhe ishte dhënë pas shkrimeve dhe se nuk mendonte për fejesë e martesë. Ndërkaq, përkundër dëshirës së tij, i ati Toni e kishte fejuar me vullnetin e vet si prind. Me të përcjellur të grishtarit, një ditë të enjte, Antoni merrë çantën me shkrimet e veta dhe niset për rrugë... Thuhej: humbi Ndou i Tonit Pashës Gjonit ?. Nuk dihet kah shkoi... Familjes iu dasht për ta anuluar dasmën dhe për të prishur miqësinë.....

Pas një kohe, në besedë me Anton Pashkun, më tha: Unë e kisha idenë time për të shkruar disa tregime, drama dhe romanin e planifikuar, e çka jo tjetër. Ndërsa i ati kishte planifikuar martesën time-pa pëlqimin tim. Me këtë rast u krijua një OF apo OH - e madhe, ndryshe thënë: ofshamë e brendëshme shpirtërore: Unë dhe familja ? Babait i kisha thënë: Oh bre babë, pse po u hyn këtyre llugave? Dhe ika...! Nërsa baba m'u pat përgjigjur: Oh bre bir –pse po ma prish qejfin ! ? Ndoshta kjo rrethanë e të tjera ndikuan që Anton Pashku ta titullojë romanin, me- “OH”. Duhet shtuar se edhe i ati i Antonit –Toni, ishte një humorist i hollë e meselegji. Ndër të tjera thoshte: Oxhaku pa dru është si Burri pa gru-e... etj.

Në prag të kësaj tollovie që u krijua në familje, deklaron Antoni: unë shkova në një vendbanim fushor në Vojvodinë, kur vjeshta ishte e ngarkuar me punë fushe. Fshati kishte një qetësi apsolute. Fshatarët bënin gjumë të vonë, vetëm 3-4 orë pas mesnate. Nuk pata bërë as më të voglën bisedë me pronarin e shtëpisë. Përveq goditjes në fillim dhe pagesës në fund. Shtëpia, liria, shkrimi e qetësia totale ishin të miat. Jetonim: Unë me hijen time dhe tymin e cigarë, me orenditë e dhomës dhe inventari me hijet dhe erën e tyre me të cilët bisedinim në heshtje...

Kohë më parë, para se të ndërrojë jetë, në një takim, mezi ia nxora fjalët kur më tha: Djalin e kam burrë për emër ndërsa vajzën Lule për zemër.

Anton Pashku vdiq më 31 tetor dhe u varros më 1 nëntor 1995 në Shëngjergj, pranë babait të vet, mu në

Ditën e të Vdekurve

Përsonat që i përmendëte në Zym ishin: Llesh Shtjefën Kolndrekaj (axha i tij- për ngjarje historike), halla Martë (motra e babës, në Lunezh-për jetë familjare), dajat: Dodë Nikë Kërhanaj (vëlla i nënës –për surpriza e mesele kopilhanqe) dhe Mark Frrok Kërhani (për të cilin kishte simpati sepse punonte-mjeshtronte vegla nga jeta e punime nga druri e lëkura,si: qerre e saje druri, parmendë e vllaçë, samarë për kali e gomarë, kupllicë për djathë e turrëshi, lugë druri, saj për rrëshqitje për fëmijë, tarçuk për ushqim e bukë, e vogla tjera pune. Ishin këto bisedat që i përfolnim për ta rikujtuar jetën fshatarake në Zym.

Dhe, nga këto përkujtime, Anton Pashku, më preferonte që të formojmë një punëtori me dru paje nga Pashtriku, për punimin e veglave bujqësore dhe mjeteve të amvisnisë për ta ruajtur dhe kultivuar traditën tonë kombëtare si nga veglat bujqësore, ato të amvisnisë, të vektarisë e të tjera, që njëherit më preferonte -edhe për shitje e tregti...

ARKEOLOGU I DIJES, INJAC ZAMPUTTI

Injac Zamputti lindi më 12 shkurt të vitit 1910 në Shkodër, vdiq më 28 shkurt 1998 në Tivoli (Itali) dhe, sipas porosisë së tij të fundit, eshtrat e tij prehen në varrin e familjes në Tiranë. Shkrimtar, albanolog, publicist dhe historian i njohur.

Jeta e përkthyesit dhe kritikut letrar për të sjellë në gjuhën shqipe tekste të huaja, si dëshmi e identitetit tonë. Puna e tij i tejkalonte raportet me sigurinë dhe domosdoshmërinë për t'i qëndruar besnik origjinalit

Kultura shqiptare nuk është e pasur vetëm materialisht, me vepra e kontribute të personaliteteve të saj, të shuar e fikur rrënimeve dhe zgafellave të diktaturës dhe tranzicionit të stërgjatur shqiptar, por edhe si frymë që mbijeton përtej kohërave dhe hapësirave të datave egzakte të lindjeve dhe vdekjeve të personaliteve të saj. Kjo frymë që ka mbizotëruar gjithandej në tekstet dhe kulturën tonë ka krijuar shenjtorë dhe martirë të gjallë të stërmundimeve për të sjellë në shqip tekste të huaja, si dëshmi të veçanta të identitetit tonë. Një nga ta, padyshim është dhe profesor Zamputti, që brezi i pas viteve 90' për fat të mirë pati fatin ta njihte, jo vetëm si përkthyes të dokumentacionit rreth Shqipërisë në Propagandën Fide në vitet '60, por edhe si kritik letrar dhe estet në sprovat e tij rreth Fishtës e Kadaresë, apo dhe si dramaturgun që mishëroi në personazh Damianin nga Himara që i bëri atentat Sulltan Sulejmanit të II në 1537.

Qytetërimi ynë, ka pasur fatin e keq që dëshmitë e veta të shkruara t'i ketë të pakta dhe më tepër të njihet përmes dokumentacionit të huaj dhe se çfarë kanë shkruar të tjerët për ne. Një punë kolosale, që ka nisur prej 300 vjetësh më parë në relacionet e Bardhit, qysh atëherë kur fati i arbërit shënjohej në delirin e vet të ekselencës, e që dëshiroj ta përkufizoj duke huazuar një term nga Fuko, si arkeologjia e dijes për të mbledhur çdo detaj dhe të dhënë të hapësirës shpirtërore artere e më pas shqiptare të shpërndarë gjithandej nëpër dijen e botës në gjuhë të huaja, është konkretizuar në disa botime shumë të vlefshme dhe të çmuara për identitetin tonë. Libri "Dokumente për Historinë e Shqipërisë (1623-1653), është pikërisht një libër i tillë, njëfarë udhëtimi shpirtëror dokumentuar mbi etninë arbëre dhe lidhjet e tij shpirtërore me Selinë e Shenjtë gati 110-130 vjet pas pushtimit të Shkodrës dhe dhënies fund të qendresës së organizuar arbëre.

Sipas fjalëve të birit të vet Jozef Zamputtit, puna e kryer nga profesor Zamputti ishte një punë që tejkalonte raportet me sigurinë dhe domosdoshmërinë për t'i qendruar besnik origjinalit. Edhe për këtë vëllim, metoda e punës së autorit është po ajo e vëllimeve të mëparshme: leximi i qëmtuar i dokumentit, duke e hedhur me shkrimin e tij të bukur e të qartë në fletore të veçantë. Kjo punë bëhej shpesh me thjerrëz (lente) në dorë për të gjetur edhe pikat më të vogla e shkronjat më të ngatërruara të shkrimeve, nganjëherë pothuaj të palexueshme e shpesh të prishura nga koha. Nga fletorja e shkruar këtë lexim e hidhte në makinën e shkrimit.

Edhe këtë punë gjithmonë e ka bërë ai vetë, pa ia dhënë asnjë daktilografisti, sepse me këtë mënyrë kontrollonte edhe një herë saktësinë e transkriptimit. Pastaj fillonte punën e përkthimit, të cilën e bënte direkt në makinën e shkrimit. Njëkohësisht ndërtonte skedarët me emrat e personave, vendeve, etj. duke shënuar numrin e dokumentit dhe faqen se ku gjendeshin. Kjo listë emrash vendosej në fund të vëllimit në mënyrë që studiuesi e lexuesi të kishte mundësi ta gjente menjëherë dokumentin ku flitej për atë person, për atë vend etj.

Rikrijimi i jetës shpirtërore dhe materiale të etnosit arbër nuk është një utopi, bie fjala si rindërtimi i monumenteve të zhdukura dhe të rrënuara, pasi nëse në arkitekturë teknikat e ndërtimit mesjetar janë shpeshherë jo fort të dokumentuara qartë apo në kohën e sotme moderne jemi neglizhent ndaj përdorimit të të njëjtave materiale dhe teknikave të kohës së mëparshme, fjala e shkruar që përshkruan në trajtën e dokumentit është nëpër arkiva dhe pret veçse durimin, seriozitetin dhe skrupolozitetin e arkeologut të dijes për tu shplurosur, përkthyer dhe botuar që të sotmit të dinë kalvaret, gëzimet, përpjekjet, stërmundimet e të parëve.

Përdorimi i këtyre thesareve dokumentare dhe shpirtërore me seriozitet akademik është një sfidë e përhershme e historianëve për t'u dhënë veprave të tyre fuqinë e vërtetësisë dhe mendimit analitik të tyre, dokumente mbështetëse dhe për t'iu larguar sa më shumë fantazisë në histori që Anatol Franc te "Krimi i Silvestër Bonarit" e quante si proces që "historia që ishte një art dhe lejonte të gjitha fantazitë e imagjinatës, sot ka arritur të bëhet shkencë, në të cilën duhet të ecet me një metodë të përpiktë". Arkeologjia e dijes mendoj se është një nga mënyrat se si ne mund të nxjerrim në dritë të shkuarën, jo për ta ringjallur por për të njohur më mirë gjurmët e identitetit tonë.

“HISTORIJA E SHQYPNIS “ EDHE NË PRISHTINË

Me iniciativën e famullitarit të Katedrales së Shkodrës, Dom Artur Jaku, dhe përkrahjen e drejtorit të Institutit Albanologjik, prof. Hysen Matoshi dhe studiueses prof. Shefkije Islami, në ambientet Institutit në Prishtinë, me dt. 2 Dhjetor 2015.u promovua ribotimi i librit të romansierit të parë shqiptar, Dom Ndoc Nikaj, Historija e Shqypnisë,vell. I e II, botuar nga Famullia e Shën Shtjefnit në Shkodër dhe shtëpia botuese, Enti Gjergj Fishta, Lezhë, 2015.

Në sallën e mbushur me studiues e dashamirëse të kulturës, në këtë takim, nga Shkodra foli, Dom Artur Jaku i cili theksoj se “ Nikaj, është autori i idealeve të mëdhaja, kurues i plagëve e mentaliteteve mbytëse, është ndër të parët që e zbuloi fytyrën e vërtet të komunizmit përpara se të shfaqej e të bëhej realitet i dhimbshëm”. Studiuesja nga Universiteti i Shkodrës, prof. Nartilja– Haxhia Ljarja, e cilësoj Dom Ndoc Nikaj, një ndër apostujt e shqiptarizmës, që gjithë jetën e tij ia kushtoi fesë, atdheut dhe kulturës shqiptare. Ai nuk është vetëm një ndër themeluesit e romanit shqiptar, por ai njihet edhe si një historian me dy vepra rreth historisë së Shqipërisë të cilat jemi duke i promovuar sot. Studiuesit nga Kosova dhanë vlerësimet e veta: Akademik, Rexhep Qosja, tha se, “sipas librit shkencor historiko–letrar, “Shkrimtarët shqiptarë”, si tekst përgjithësues, Dom Ndoc Nikaj radhitet ndër shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare. Por, mendoj se duhet rradhitur ndër shkrimtarët e brezit të tretë të Rilindjes sonë Kombëtare. Prof. Shefkije Islamaj, tha se, “autorit nuk i duheshin vetëm dijet e nevojshme për këtë histori, por i duhej edhe gjuha me të cilën do të realizonte qëllimet e tij dhe për këtë ishte i vetëdijshëm Nikaj”. Kurse, prof. Hysen Matoshi, nënvizoj se, pikërisht dashuria e autorit ishte motivi më i madh për ta shkruar një Histori të Shqipërisë, për ta bërë vendin e kombin me një vepër në të cilën përshkruhej e kaluara e lavdishme e të parëve. Historiani, prof. Memli Krasniqi, vuri në dukje, se Dom Ndoc Nikaj është një personalitet që jetoi në një periudhë historike vendimtare për historinë e popullit shqiptar, kohë në të cilën shqiptarët, bënë përpjekje të mëdha për mëvetësi. Në ketë takim, morën pjesë, Mëkëmbësi i Kryedioqezës se Shkodrës, Dom Nikollin Toma, Dom Nikë Ukgjini dhe botuesi Frano Kulli.

Takimi u shoqërua me disa pika muzikore nga pianistja, Rozeta Leka dhe violinistja Klodiana Matija.

VITRINË LIBRI

Volter

TRAKTAT MBI TOLERANCEN

Botimet SARAS, Tiranë, 2015

Anton Nikë Berisha

KËNGA E KËNGËVE

Prishtinë - Shkodër 2014

KUVENDI II (1871) DHE KUVENDI III (1895) I ARBNIT

Botime Françeskane
Shkodër, 2015

KUMBONA E SË DIELËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 1000 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë